

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.4 - APRILE/PRILL 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543

MARKELIAN KAPIDANI

Jazzi im ballkanik

Pinjoli i bajrakut më të famshëm të Mirditës, protagonist i jetës kulturore shqiptare të pas-diktaturës, sot është një zë i njohur i panoramës së jazz-it italian. Apo edhe shqiptar? Pasi Kapidani, besnik ndaj emrit të vet e në kërkim të përhershëm, sjell edhe harmonitë e veçanta të përfuara nga ndërthurja e ritmëve dhe melodive të mirëfillta të jazz-it me traditën muzikore mesdhetare e shqiptare



7 prill 1939, e premte

“Koha, e bukur”

Orët e pushtimit të Shqipërisë në fletët e ditarit ushtarak të komandantit të përgjithshëm të regjimentit III të bersaljerëve .



WESTERN UNION |
MONEY TRANSFER

www.stranieriinitalia.it
il portale dell'immigrazione

Ç'fjalë të sjellin ndërmend Italinë? LEJEQËNDRIM DHE RACIZËM

Sondazh mes lexuesve të stranieriinitalia.it mbi fjalët që të bëjnë të mendosh Italinë.
Fjala e fundit "gëzim"

Italia belpaese? As që e çojnë nëpër mend. Italia, për emigrantët që jetojnë këtu, para së gjithash do të thotë burokraci dhe racizëm. E thonë rezultatet e një sondazhi që stranieriinitalia.it bëri mes lexuesve të vet. Pyetja ishte: "Cila fjalë të bën të mendosh më shumë për Italinë?". Lexuesit mund të zgjidhnin mes 12 opsionesh: mikpritje, e bukur, shtëpi, e keqe, klandestin, gëzim, nostalgji, oportunitet, lejeqëndrim, polici, inat, raciz2m. Sondazhi u drejtohej vetëm emigrantëve (natyrisht nuk mund të përfshihet që mund të ketë pasur edhe ndonjë "të infiltruar") dhe janë përgjigjur rreth dhjetë mijë vetë. Ajo çka doli në dritë nuk është aspak e gëzueshme.

Në majë të listës së fjalëve që të bëjnë të mendosh për Italinë janë "lejeqëndrim" me 3.339 vota (34,2% e të gjitha përgjigjeve) dhe "racizëm" me 2.774 vota (28,5%). Këto të dyja kanë thithur mëse 60% të të gjitha përgjigjeve. Madje, edhe pse 962 vota (9,9%) dhënë për "e bukur" vlejnë sidoqoftë vendin e tretë në renditje, fjala "gëzim" renditet e fundit me vetëm 71 vota. Nuk është për t'u çuditur që "leja e qëndrimit" renditet e para, po të mbahet parasysh që në Itali është dokumenti më i rëndësishëm për një të huaj. Por ajo çka rëndëson më shumë në këtë zgjedhje është fakti që nga 500 mijë deri në 1 milion (sipas mendimit të kuesturave apo të shoqatave të sektorit) emigrantë janë gjithnjë në pritje të dokumentit të tyre, pengje të një burokracie shumë të ngadaltë. Shumë e kanë shprehur këtë gjë edhe me komentet në fund të artikullit që paraqiti sondazhin. "Ah, leja e qëndrimit. Për ta marrë duhet të presësh, po të të shkojë mbarë, një vit" "Jam gjithnjë në radhë për përtëritjen, në radhë për identifikimin, në radhë për integrimin e dokumentacionit, në radhë për ta marrë, por kur e kam në dorë shoh që është e skaduar e duhet ta nis prapë nga e para. Italia po

na vështirëson jetën". Për fat të keq nuk është vetëm burokracia ajo që i bën të huajt të ndihen shtetas të dorës së dytë. Ndihet shumë racizmi, veçanërisht me përgjithësimet e alarmit për sigurinë. Edhe në këtë aspekt komentet flasin qartë: "Këtu konsiderojnë të gjithë të huajt përdhunues dhe kriminelë, çdo ditë thonë që duhet të largohemi, që nuk duhet pasur mëshirë". "Na shfrytëzojnë e në trajtojnë si qentë, ky është racizëm". "Italiani mendon se është qenie superiore përballë emigrantit të gjorë dhe harron që i huaji flet më mirë se ai 2-3 gjuhë. I bukur vend!".



Qeveria përpiqet të jetë sa më efikase në dëbimin e klandestinëve duke e çuar deri në 6 muaj kohën maksimale të qëndrimit të tyre në qendrat e identifikimit në pritje që riadhesimi të bëhet i mundur. Këtë e parashikon një dekret që hyri në fuqi në fund të shkurtit.

Më parë, teksti unik i imigracionit parashikonte mbajtjen për maksimumi 60 ditë të klandestinëve nëse haseshin vështirësi në identifikimin e tyre apo në sigurimin e dokumenteve të domosdoshme për riadhesimin. Me të skaduar ky afat, shtetasi i huaj lihej i lirë me një fletë dëbimi në dorë.

Tani për dikë që ndalohej dhe që nuk bashkëpunon për identifikimin e vet, apo për të cilin

nuk mbërrijnë dokumentet e nevojshme për ta dërguar në atdhe, brenda 60 ditëve, Kuestori mund t'i kërkojë gjykatësit të paqes 60 ditë të tjera mbajtjeje në qendrat e identifikimit, e nëse as këto nuk janë të mjaftueshme, mund të kërkojë një tjetër zgjatje kohe po për 60 ditë. Zgjatje pas zgjatjeje, klandestinët mund të qëndrojnë kështu të mbyllur në qendrat e identifikimit dhe të dëbimit (CIE) deri në 180 ditë, natyrisht nëse nuk arrihet të riadhesohen para këtij afati. Risia prek edhe ata që ndodhen tashmë në këto qendra, si shtetasit tunizianë që javët e shkuara u rebeluan në qendrën e Lampeduzës. Shpesh nuk arrihet të dëbohet kush ndalohej e është pa doku-



Ministero per le Pari Opportunita



UNAR
Ufficio Nazionale
Antidiscriminazioni Razziali

Viktimë e racizmit?



Telefono falas NË NUMRIN E GJELBËR

800.90.10.10

BONUS BEBE

Nuk mjaftonte "social card" rezervuar italianëve. Edhe një tjetër kontribut që qeveria ka destinuar për familjet më të varfra do të lërë duarbosh emigrantët dhe fëmijët e tyre. Dekreti anti-krizë, i konvertuar në ligjin 2/2009, në nënin 19 parashikon një lloj bonus-bebe. Vihen mënjane 2 milionë euro për t'u rimbursuar më nevojtarëve "shpenzimet për blerjen e qumështit artificial dhe të pelenave për të sapolindurit me moshë deri në tre muaj".

Por këto rimbursime nuk mund t'i marrin prindërit e huaj. Në fakt, po në nënin 19 thuhet që përfutuesit do të jenë të njëjtit e "Fondit për qytetarët më në nevojë", fond i rezervuar pikërisht vetëm për italianët.

Këtë herë diskriminimin e denoncon Shoqata e Studimeve Juridike mbi imigracionin (ASGI), që konsideron të jashtëligjshëm përjashtimin e të huajve. Një gjë e tillë do të shkelte një sërë konventash ndërkombëtare:

Klandestinët deri në 6 muaj në QENDRAT E IDENTIFIKIMIT

Më shumë kohë për identifikimin. Mund të mbahen deri në 180 ditë nëse riatdhesimi është i vështirë

mente qëndrimi. Para së gjithash sepse është e vështirë të mësohet identiteti i saktë i të ndaluarit që shpesh jep emra të ndryshëm të rremë (janë edhe për të qeshur rastet e sjella nga shtypi italian për kapje shqiptarësh klandestinë të quajtur Filan Fisteku apo Qeros Nastradini), por edhe për shkak të zvarritjeve burokratike për ripranimin e klandestineve nga vendet prej nga vijnë, me të cilat mungojnë marrëveshjet mbi flukset klandestine (kjo nuk vlen për Shqipërinë që në pranimin e klandestineve që i kthehen nga Italia merret si shembulli më pozitiv prej kësaj të fundit). Me më shumë kohë në dispozicion, qeveria shpreson të zgjidhë edhe këtë problem.

Rregullat e reja do të tejmbushin akoma më shumë qendrat ekzistuese e do të bëhet e pashmangshme hapja e të rejave. Objektivi i ministrisë së Brendshme është të ketë të paktën një CIE për çdo krahinë, por me siguri nuk do ta ketë të lehtë vendosjen e të rejave pasi këtë aspekt duhet të kapërcejë qëndresën e kryebashkiakëve: nuk është e lehtë të gjejnë një që është dakord me hapjen e strukturave të tilla në territorin që administron. Ndërkohë, dekreti në fjalë ka caktuar përdorimin e një shume prej 230 milion eurosh për zbatimin e tij, më shumë se gjysma e të cilës është destinuar pikërisht për ndërtimin e rristurimitin e qendrave të identifikimit dhe të dëbimit.

Qumësht e pelena vetëm për italianët

Për "bonus bebe" të dekretit anti-krizë nevojitet shtetësia.

ASGI: "Është e jashtëligjshme"



nga ajo e Organizatës ndërkombëtare të punës (ILO) mbi bazinë e trajtimit mes punonjësve të huaj dhe atyre vendas deri te konventa europiane mbi të drejtat e njeriut, nga

Karta e Nju Jorkut kushtuar të drejtave të fëmijëve deri te konventa e Gjenevës mbi të drejtat e refugjatëve.

Për më tepër, bonus-i bebe vetëm për italianë do të hidhte poshtë edhe barazinë e trajtimit e parashikuar nga drejta komunitare për të gjithë shtetasit e BE-së dhe qëndruesit afatgjatë jokomunitarë.

Ka aq shumë shkelje sa mund të kërkohet një ndërhyrje nga Brukseli: në fakt, ASGI paralajmëron se "do t'i dërgojë Komisionit European një notë thirrjeje (complaint) për ta shtyrë që të verifikojë mosrespektimin e të drejtës europiane nga Italia dhe të nisë një procedurë shkeljeje kundër saj".

FLUKSE 2009

Qeveria: "S'ka flukse jostinorësh për 2009-n"

Do të hyjnë vetëm punonjës stinorë. Maroni: "Kështu mbrojmë ata që rrezikojnë vendin e punës"

Për vitin 2009 u mbyllet rruga punëtorëve, bashkëpunëtorëve familjare dhe punonjësve të tjerë të huaj jostinorë. Këtë vit qeveria do të autorizojë vetëm ardhjen e 80 mijë punonjësve stinorë, që pas disa muajve punë në bujqësi, restorante dhe hotele që kanë nevojë për kohësisht për ta, duhet të kthehen nga kanë ardhur.

Pezullimi për vitin 2009 i dekretit të flukseve, u paralajmërua më 18 mars në Dhomën e deputetëve nga ministri i Brendshëm Roberto Maroni, që tha se në këtë mënyrë mund "të mbrojmë punonjësit që rrezikojnë të humbasin vendin e punës" për shkak të krizës ekonomike. Qenë pikërisht senatorët e Legës, partisë së Maronit, ata që kërkuan të parët një ndërhyrje në këtë drejtim.

"T'u hapen dyert vetëm stinorëve duke bllokuar hyrjen e punonjësve të tjerë të huaj është një zgjedhje e Legës, krejtësisht arbitrare, që nuk mban parasysh aspak nevojat e vendit. Nëse qeveria do të kishte konsultuar sipërmarrësit dhe pushtetin lokal, siç parashikon ligji, duhet të kish bërë një program ndryshe" komenton Jean Leonard Touadi, deputet i PD-së. "Duke bllokuar flukset legale, - denoncon ai - i hapim autostrada emigracionit klandestin".

Sipas qeverisë, të sjellësh emigrantë të tjerë nuk do të thotë tjetër gjë veçse të rrisësh papunësinë. Por duhet konsideruar që në më të shumtën e rasteve, të huajt e thirrur me flukset, ndodhen në Itali, por pa leje qëndrimi dhe punojnë në të zezë. Në mungesë të një sanatorie, flukset janë kthyer në të vetmen mundësi për t'u vënë në rregull: nëse kërkesa pranohet, klandestini kthehet në atdhe, merr vizën dhe hyn sërish në Itali, ku më në fund mund të kërkojë një leje qëndrimi.

Ndërkohë, janë rreth gjysmë milioni mes familjesh dhe ndërmarrësish që ende presin një përgjigje për flukset e hyrjes së viteve 2007 dhe 2008. Mëse 700 mijë nisën kërkesat e punësimit në dhjetor të vitit 2007, por shpërndarja e 320 mijë hyrjeve të vëna në dispozicion nga qeveria për këta dy vjet akoma nuk ka përfunduar. Në fillim të marsit, autorizimet e lëshuara ishin vetëm 130 mijë, 70 mijë ishin kërkesat e hedhura poshtë, gjithë të tjerët ende nuk dinë se dhe kur do të marrin përgjigje.

80 mijë stinorë, firmoset dekreti

Punonjës stinorë për bujqësinë e turizmin.

Ja kujt i hapen dyert

Pas disa muajsh pritjeje, më në fund mbërriti edhe dekreti i flukseve 2009 për punonjësit stinorë jokomunitarë, për bujqësinë dhe turizmin. Më 20 mars kryeministri italian nënshkroi tekstin që autorizon 80 mijë hyrje të reja punonjësish stinorë.

Me këtë dekret do të mund të hyjnë në Itali:

a. Punonjës të varur stinorë jo komunitarë nga Serbia, Mali i Zi, Bosnja-Hercegovina, Maqedonia, Kroacia, India, Pakistani, Bangladeshi, Sri Lanka e Ukraina.

b. Punonjës stinorë të vendeve që kanë nënshkruar me Italinë marrëveshje bashkëpunimi për çështje të emigracionit: Tunizia, Shqipëria, Maroku, Mòldavia ed Egjipti.

c. Pavarësisht nga vendlindja, të huajt jo komunitarë titullarë lejesh qëndrimi për punë të varur stinore në vitet 2006, 2007 ose 2008.

Dekreti ende nuk është botuar në Gazetën Zyrtare ndaj tani për tani nuk është e mundur të paraqitet kërkesa. Sapo të bëhen të ditura detajet dhe dita e parë e vlefshme për paraqitjen e kërkesave, punëdhënësit duhet t'i nisin ato on-line, vetë apo të ndihmuar nga shoqatat e kategorisë.

Artikuj të përgatitur nga Elvio Pasca
stranieriinitalia.it

Ç'rrezikon punëdhënësi i bashkëpunëtores familjare pa lejeqëndrim?

Sipas tekstit unik për imigracionin (dekreti legjislativ 286/98), punëdhënësi që merr në varësi të tij një punonjës jokomunitar pa lejen e qëndrimit (që nuk e ka pasur asnjëherë, që i është tërhequr, apo që i ka skaduar e nuk e ka përtërirë) ndëshkohet me heqje lirie nga 6 muaj deri në 3 vjet dhe me gjobë prej 5.000 eurosh për çdo punonjës të parregullt të marrë në punë.

Ndëshkimet e sipërpërmendura, në të vërtetë kanë hyrë në fuqi korrikun e shkuar me nenin 5 të ligjit 125/08 që ka modifikuar nenin 22 të tekstit unik, duke ashpërsuar ndjeshëm ndëshkimet (fillimisht parashikohej heqja e lirisë nga 3 muaj deri në një vit). Kujdes! Sanksionet penale aplikohen edhe kur punonjësi është me dokument qëndrimi, por që nuk i të kryejë punë (si për shembull, ka deklaratën e pranisë që ka zëvendësuar lejen e qëndrimit për turizëm). Ndaj, për të mos rrezikuar, është e rëndësishme të verifikohet nëse bashkëpunëtorja familjare e ka lejeqëndrimin si dhe motivin për të cilin e ka marrë. Në lejeqëndrimet e reja elektronike, nuk shënohet motivi i lëshimit dhe për sa kohë nuk do të zëvendësohen nga modeli i ri i lejeqëndrimeve (në fazë aktualizimi), punëdhënësi ka për detyrë të kontrollojë të paktën që punonjësja ka dokumentin e qëndrimit. Ky parim është pohuar disa herë nga Gjykata të ndryshme, madje së fundi edhe nga Gjykata e Lartë e Diktimit.

Nëse bashkëpunëtorja familjare nuk ka qëndrim të rregullt në Itali, punëdhënësi është sidoqoftë i detyruar të aplikojë parimet e përgjithshme të të drejtës së punës. Në çastin e "punësimit", edhe pse nuk e formalizon atë në INPS, lidhet një kontratë e mirëfilltë pune, me të gjitha detyrimet/të drejtat që burojnë.

Kështu, punëdhënësi është i detyruar t'i paguajë rrogën e trembëdhjetë, t'i japë pushimet, e mbi të gjitha, ta paguajë sipas tabelave të përcaktuara çdo vit nga INPS-i. Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, bashkëpunëtorja familjare mund të kërkojë me të drejtë shumën e "trajtimin në fund të marrëdhënies" (të ashtuquajturin "TFR-Trattamento di fine rapporto") ose shumën të tjera që nuk ka marrë, dhe në rast mosmarrëveshesh me punëdhënësin, mund t'i drejtohet Gjykatës të Punës për t'i kërkuar njohjen e të drejtës së tij.

Të mbahet parasysh që në Europë, në shkur Parlament

miratoi një direktivë që parashikon ndëshkime të ashpra, qoftë civile qoftë penale, për punëdhënësit në rast marrëdhëniesh pune me të huaj të parregullt.

Kjo direktivë ndalon punësimin e shtetasve jokomunitarë me qëndrim të parregullt dhe përcakton norma minimale të përbashkëta lidhur me sanksionet që u duhen aplikuar punëdhënësve që shkelin këtë direktivë. Në rast shkellesh të këtij ndalimi, punëdhënësi do të jetë i detyruar të derdhë një shumë të barabartë me taksat dhe kontributet shoqërore që duhet të kish derdhur në rast punësimi të ligjshëm, përfshirë kamatat e vonës dhe sanksionet administrative. Parashikohen edhe sisteme mbrojtjeje sindikale për emigrantët klandestinë, të cilët, në raste shfrytëzimi, mund të kërkojnë leje qëndrimi nëse denoncojnë punëdhënësit "fajtorë".

Avv. Mascia Salvatore
www.stranieriinitalia.it

VËRTETIMI I SHPËRBLIMEVE
Lëshohet, me kërkesë të të punësuarit, nga punëdhënësi.
Shërben për të treguar të ardhurat

Të gjithë punëtorët e varur janë duke marrë Cud-in, certifikatën që përmbledh pagesat e punëtorëve për vitin 2008, i rëndësishëm për deklarimin e ardhshëm të të ardhurave. Por për bashkëpunëtorët familjare ekziston një tjetër sistem.

Kontrata e punëtorëve shtëpiakë parashikon që "punëdhënësi, me kërkesë të punëtorit, të lëshojë një deklaratë nga e cila të rezultojë shumën e përgjithshme e shumave të dhëna gjatë vitit". Nëse bashkëpunëtorja familjare, e kërkon, punëdhënësi duhet të dorëzojë një deklaratë me të gjitha pagesat e vitit paraardhës, një dokument të vlefshëm për marrëdhëniet fiskale, dhe nëse punëtorja nuk është italiane edhe për të tjera raste.

Për ata që kërkojnë të përtërijnë lejeqëndrimin apo të mundëso-

jnë mbërritjen në Itali të burrit e të fëmijëve, me një bashkim familjar për shembull, kërkohet të tregojnë që kanë të ardhura më të larta se sa disa parametra të vendosura me ligj. Në përgjithësi mjafton të tregohen kuponët e buletineve Inps, të përdorura për derdhjet e kontributeve tremujore, në bazë të të cilave kuesturat dhe sportelet unike për imigracionin mund të deduktojnë pagesat e marra nga bashkëpunëtorja familjare. Por nëse buletineve u shtohet deklarata e mësipërme, puna thjeshtohet për zyrat dhe ndoshta mund të shkurtrohet koha. Për punëdhënësin nuk është e vështirë plotësimi i kësaj kërkesë: duhet vetëm të mbledhin pagesat e vitit të kaluar, që nga ana tjetër duhet të rezultojnë nga prospektet e rrogës mujore.

COLF & BADANTI

KONTRIBUTET E TRIMESTRIT TË PARË 2009
BRENDA DATËS 10 PRILL

Brenda dhjetë prillit duhet të paguhet kontributet INPS të punonjësve familjarë për tremestrin janar-mars 2009.

Mund të përdoren buletinet postare të dërguara nga INPS-i të gjithë punëdhënësve (kush nuk i ka marrë mund t'i tërheqë personalisht pranë një zyre të INPS-it ose t'i kërkojë në numrin e telefonit 803164), ose të paguajë online, në faqet internet të institutit www.inps.it. Në disa qytete, pagesa e kontributeve mund të bëhet edhe në pikë-shitjet e cigareve.

Kontributi për bashkëpunëtorët familjarë përcaktohet në bazë të rrogës dhe të orarit javor: nëse ky i fundit nuk kapërcen 24 orë në javë, kontributi matet sipas tri grupimeve të pagës në orë; nëse orari i punës është të paktën 25 orë në javë, kontributi që duhet derdhur është fiks, sado që të jetë paga për orë e të punësuarit.

Ja shumat e kontributeve për çdo orë, për marrëdhënie pune deri në 24 orë në javë:

- për pagë/orë deri në 7,17 euro, kontributi është 1,33 euro (nga i cili 0,32 euro në ngarkim të punonjësit); - për pagë/orë nga 7,17 euro deri në 8,75 euro, kontributi është 1,50 euro (0,36 punonjësit); - për pagë/orë mbi 8,75 euro, kontributi është 1,83 euro (0,44 euro në ngarkim të punonjësit).

Në rast marrëdhënieje pune prej të paktën 25 orësh në javë (që të gjitha pranë të njëjtit punëdhënësi) kontributi për orë pune është i pandryshueshëm, 0,97 euro (nga i cili 0,23 euro në ngarkim të punonjësit).

Punëdhënësi duhet të derdhë të gjithë shumën e kontributeve, përfshirë kuotën në ngarkim të punonjësit, të cilën mund t'ia mbajë nga rroga.

shqiptari i italisë
l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i
Bota shqiptare
gazeta e shqiptarëve në itali

BOTIMI / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIONI / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE É ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORË / IN REDAZIONE Keçi Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

ISTITUTO LUCE
PRESENTA



ALBANIA

IL PAESE DI FRONTE

REGIA
ROLAND SEJKO
MAURO BRESCIA



LUCE

**IL PRIMO DOCUMENTARIO
SULLA STORIA DELL'ALBANIA**



REGIONE LAZIO

N E L L E M I G L I O R I L I B R E R I E

EMIGRANTËT S'BLEJNË MË SHTËPI

Me krizën, bien edhe blerjet e shtëpive nga të huajt

Kriza ekonomike ka ndaluar edhe vrapin e të huajve për të blerë pasuri të patundshme në Itali: mes kredive të dhëna me pikatore dhe paqëndrueshmërisë së vendit të punës, janë gjithnjë e më të paktë ata që arrijnë të blejnë shtëpi.

"Nga boom-i te sboom-i" mund të përmbledhë më së miri raportin mbi "Emigrantët dhe shtëpia 2009" i institutit të kërkimeve Scenari Immobiliari, që me 620 intervista me agjentët e shitblerjeve të pasurive të patundshme dhe kampione blerësish emigrantë sjell të dhënat mbi shitblerjet e vitit të shkuar dhe bën parashikime për vitin 2009. Gjithçka del me shenjë negative.

Në vitin 2008 blerjet e pasurive të patundshme nga emigrantët kanë qenë 103 mijë duke pësuar një rënie prej 23,7% kundrejt një viti më parë. Edhe sasia e parave të shpenzuara ka pësuar rënie me 30%, ndërsa çmimi mesatar i banesave të blera ka zbritur nga 124 mijë në 113 mijë euro.

Parashikimet për fundin e vitit 2009 flasin për një rënie të mëtejshme, qoftë për sasi shtëpish të blera e qoftë për sasi parash të shpenzuara (mesatarisht 110 mijë euro). Sipas institutit Scenari Immobiliari, deri në fund të vitit do të përmbillen rreth 90 mijë kontrata shitblerjeje, prej të cilave vetëm 35 mijë



në gjashtëmujorin e parë, me një rënie prej 40% kundrejt gjashtëmujorit të parë 2008. Pritet një përmirësim gjatë semestrit të dytë 2009, me rimëkëmbjen e tregut financiar, por natyrisht ky është vetëm parashikim e duhet pritur për të parë nëse do të verifikohet vërtet.

"Kjo situatë është pasojë e drejtpërdrejtë e shtrëngimit mbi dhënien e kredive, që gjatë muajve të fundit ka provokuar ngadalësim për të gjithë grupin me të ardhura të ulëta të tregut të shitblerjeve të shtëpive. Kësaj i shtohet edhe kriza ekonomike që ul qëndrueshmërinë e të ardhurave dhe rrit rrezikun e

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2009 do të blihen 40% më pak shtëpi se gjatë po të njëjtit gjashtëmujor të një viti më parë.

Këtë nxjerr në dritë raporti i fundit i institutit kërkimor "Scenari immobiliari"

papunësisë" shpjegojnë për-piluesit e raportit.

"Për emigrantët - lexohet në raport - procedurat për përfitimin e kredisë janë edhe më të ngurta se për italianët dhe praktikata për dhënien e një kredie mund të zgjasin muaj me radhë, gjë që ngadalëson ndjeshëm kohën e shitblerjes".

Ashtu si edhe vitet e tjera të fundit, gjatë vitit 2008 të huajt që blejnë shtëpi në Itali vijnë kryesisht Europa Lindore (38%), të ndjekur nga indianë (21%) dhe kinezë (16,5%). Parapëlqejnë apartamente nga 50 deri në 80 metra katrorë, në periferi e në komuna të vogla të lidhura me mjetet publike, duke shpenzuar mesatarisht 113 mijë euro.

SPORTELI UNIK I IMIGRACIONIT - ROMË

MË SHUMË INFORMACIONE

Çdo të mërkurë të dhëna për flukse dhe bashkimet familjare.

"Por ndërkohë na shkurtojnë personelin" denoncon zëvendës prefekti i Romës

Ata që përpiqen të sjellin një punëtor të huaj apo një familjar në Itali këtej e tutje, çdo të mërkurë, mund të kërkojnë informacion në sportelin unik për emigracionin në Romë. Në rrugën Ostiense 131 është hapur një sportel për të dhënë informacione mbi praktikata e rreth flukseve dhe bashkimeve familjare.

"Punon çdo të mërkurë nga ora 9 deri në 13, por po të ketë kërkesë të fortë mund të parashikojmë edhe një ditë tjetër hapjeje. Por mund ta përdorin vetëm të interesuarit e drejtpërdrejtë,

pra punëdhënësit apo ata që kanë kërkuar bashkimin familjar. Shoqatat, avokatët e sindikatat duhet të vazhdojnë të më drejtohen mua" shpjegon Emilia Zarilli, zëvendës Prefekte që drejton Sportelin.

Kanali i ri i informacioneve ishte bërë i domosdoshëm pas mbylljes së call-center-ave dhe bën pjesë në një plan më të gjerë riorganizimi. Sporteli, për shembull, pret sot çdo paradite, nga e hëna në të premte, duke nisur nga ora 9, për procedurën e "hyrjes së parë", me të cilën ata që sapo kanë ardhur në

Itali me flukset apo me bashkimet familjare, mund të kërkojnë lejeqëndrimin.

Ndërkohë, mungesës së përhershme të personelit, po i shtohet edhe një emergjencë tjetër.

"Guardia e Financës, ka vendosur të tërheqë tetë agjentë, të cilët prej tre vitesh na ndihmonin. Nëse ata nuk do të zëvendësohen nga të tjera përforcime, rrezikojmë të paralizohemi" thotë Zarrilli.

Një urdhër kombëtar për ndërmjetësuesit kulturorë

Propozim ligji në dhomën e ulët të parlamentit italian. Përkufizon formimin dhe kushtet për të ushtruar profesionin

Në një Itali gjithmonë e më multi-etnike, ndërmjetësuesi kulturor, është një figurë kyçe, në marrëdhëniet ndërmjet qytetarëve të rinj dhe atyre të vjetër, dhe mbi të gjitha midis tyre dhe institucioneve. Deri më sot ndërmjetësuesit nuk kanë një njohje të plotë profesionale, as një model formimi të vetëm.

Deputeti i PdL, Aldo Biagio, në Dhomën e Deputetëve, ka paraqitur një propozim ligjor, për ligj të deleguar, shkurtin e kaluar. Tekstin e kanë firmosur anëtarë të shumicës e të opozitës, dhe ka premisa që i sigurojnë një probabilitet të mirë për tu realizuar.

Qeverisë i kërkohet të formojë Urdhrin e ndërmjetësuesit kulturorë dhe Urdhrin e shoqatave të ndërmjetësimit kulturor, dhe të harmonizojë ligjet ekzistuese.

Më pas duhet të përkufizohet një model formimi që do të përfshijë subjektet institucionale por edhe palët sociale dhe të sektorit të tretë.

Pasi t'i jenë nënshtruar një formimi bazë, për komunikimin dhe legjislacionin e punës, kandidatët për ndërmjetësues do të kalojnë në formimin e specializuar thelbësor për të vepruar në drejtime të ndryshme (shkolla, spitale, gjykata etj). Qeveria duhet të sigurojë përdorimin e ndërmjetësuesve nga ana e institucioneve publike e private dhe nga ana e organizatave të vullnetarëve që merren me imigracionin.

Propozimi ligjor, përcakton edhe kushtet për tu regjistruar në urdhër, pa të cilat nuk mund të ushtrohet profesioni. Duhet të njihet gjuha dhe kultura italiane, si edhe gjuha dhe kultura e të paktën një vendi të huaj. Nevojitet edhe një diplomë universitare në shkencat humane, shoqërore apo gjuhësore, dhe në mungesë të saj duhet të tregohet megjithatë se plotësohen kushtet e duhura dhe të barabarta në vendin e prejardhjes.

Një normë provizore do të mbrojë ata që janë punojnë tashmë si ndërmjetësues kulturorë. Ata që kanë arritur përvojë pranë enteve publike dhe private mund të regjistrohen pranë Urdhrit brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e rregullave të reja.



shqiptari

italisë.com

portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

Më e thjeshtë të udhëtosh me kuponin e përtëritjes

Nuk është më e nevojshme të kalohet i njëjti kufi. Ngelen të vlefshme të gjitha rregullat e tjera

Një liri e vogël për ata që presin lëshimin e parë apo përtëritjen e lejeqëndrimit dhe dëshirojnë të udhëtojnë nga Italia në vendlindje. Nuk duhet më të kalojnë patjetër nga e njëjta pikë kufitare italiane: për shembull shqiptarët mund të nisen nga Roma Fiumicino e të kthehen me anije në Bari.

Kështu ka vendosur Ministria e Brendshme, e shtyrë nga problemet e të gjithë atyre të huajve në pritje të përtëritjes që dëshirojnë të lëvizin.

Në rastin konkret, shumë shtetas kroatë ishin kthyer në shtëpi duke kaluar nga Sllovenia, para 31 janarit, kur ishte ende e mundur të kalonin nëpër vendet Shengen, me një kupon përtëritjeje. Pasi skadoi ai lehtësim, rrezikonin të mbeteshin të bllokuar në atdhe, duke mos mundur më të kalonin përmes Sllovenisë, për të arritur pikën kufitare prej nga kishin dalë. Drejtoria e imigracionit dhe policia kufitare, gjeti një zgjidhje që zbatohet për të gjithë emigrantët në pritje të lejeqëndrimit. "Vendoset me efekt të menjëhershëm që - thotë telegrami urgjent i nisur më 11 mars - që të huajt mund të largohen nga territori italian dhe të hyjnë sërish edhe nga një kufi i jashtëm i Italisë, i ndryshëm nga ai i daljes".

Ngelen natyrisht të vlefshme të gjitha rregullat e tjera të udhëtimit me kupon.

Udhëtimi nuk mund të ketë ndalesë në një vend tjetër të zonës Shengen dhe kush udhëton duhet të ketë me vete edhe kuponin postar, që do të vuloset nga policia. Atyre që presin përtëritjen e lejeqëndrimit, do t'u kërkohet edhe fotokopja e lejeqëndrimit të skaduar, ndërsa ata që presin lejeqëndrimin e parë për arsye pune, apo për arsye familjare duhet të tregojnë edhe vizën e lëshuar nga konsullata që përcakton arsyen e qëndrimit në Itali.

Shtetësi më e lehtë për pasardhësit e italianëve

Nëse gjyshet kanë humbur shtetësinë duke u martuar me një të huaj, nipat kanë të drejtë të jenë italianë. Sentencë e gjykatës së Diktimit

Për shkak të një ligji të vitit 1912, të anuluar më pas sepse ishte antikushtetues, shumë emigrante italiane humbën shtetësinë vetëm sepse ishin martuar me një të huaj. Tani pasardhësit e tyre të lindur jashtë shtetit, mund ta rifitojnë atë.

Rrugën e hapi, rasti i Miriam E., e lindur në Kajro, në 1962, mbesë e një italianeje që kishte humbur shtetësinë pas martesës së saj me një egjiptian. Seksionet e bashkuara të Gjykatës së Diktimit, i kanë njohur para disa javësh të drejtën për të marrë në dorë pasaportën italiane. Duke e thjeshtuar në maksimumin e mundshëm, arsyetimi i gjykatësve është ky: nëse gjyshja nuk do të kishte humbur shtetësinë, edhe i ati i Miriamit do të ishte italian dhe do t'i kishte kaluar shtetësinë italiane të bijës. Duke qenë se ligji i cili ka shfuqizuar shtetësinë e gjyshes është shpallur antikushtetues, (diskriminonte gratë përpara burrave), duhet të korrigjohen edhe pasojat e tij. Miriam E. kishte filluar betejën ligjore në 2003, duke paditur ministrinë e Brendshme që kishte refuzuar ta njihë si shtetase italiane. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit të Romës, nuk i dhanë të drejtë, por gjykata e Diktimit e pranoi denoncimin e saj.

Ata që gjenden në pozitën e Miriamit mund të kërkojnë kështu shtetësinë, duke paditur vendimin pranë gjykatës së Diktimit. Ministria e Brendshme ka bërë të ditur se shpejt do të japë udhëzime për paraqitjen e këtyre kërkesave.



MARKELIAN KAPIDANI

Jazzi im ballkanik

Emri i Markelian Kapidani-it shumëkujt mund t'i kujtojë vitet '90, kohën kur diktatura shqiptare sapo ishte shpërbërë, Shqipëria sapo ishte hapur me botën dhe shqiptarët ishin të etur për gjithçka që kishte ndodhur përtej mureve hermetike të Shqipërisë gjatë pothuaj gjysmë shekulli izolimi. Ishte koha e entuziazmit kur të gjithë eksperimentonin, rock-u dhe jazz-i u bënë të ligjshëm dhe shpërthyen madje edhe dyert e festivalit të përvitshëm të muzikës së lehtë shqiptare, duke tronditur e revolucionuar gjithë ç'kishte

qenë më parë. Ndër figurat kryesore të asaj që ndodhte ishte edhe Kapidani, djali flokëgjatë që shfaqej festivaleve përpara orkestrës me kompozimet e dhjetëra këngëve të atyre viteve, duke u bërë një figurë e gjithëpranishme sa herë që flitej për festivalin e dhjetorit.

Por kapitulli i entuziazmit dhe i festivalit të dhjetorit është mbyllur e është lënë pas prej kohësh. Vazhdon të mbijetojë në të kundërt pasioni, entuziazmi, e thjeshtë kurioziteti për të zbuluar muzikën, jazz-in në gjithë nyjetimet e tij, të panumërta, të larmishme, e gjeografikisht të shumëartikulueshme, që lëkundën sa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aq në Amerikën Latine, në Afrikë e përmbyllen të

Pinjollit i bajrakut më të famshëm të Mirditës, protagonist i jetës kulturore shqiptare të pas-diktaturës, sot është një zë i njohur i panoramës së jazz-it italian. Apo edhe shqiptar? Pasi Kapidani, besnik ndaj emrit të vet e në kërkim të përherëshëm, sjell edhe harmonitë e veçanta të përfuara nga ndërthurja e ritmave dhe melodive të mirëfillta të jazz-it me traditën muzikore mesdhetare e shqiptare

gërshetuara me ritmet ballkanase, mesdhetare që bartin vulën e qytetërimeve të së kaluarës së largët e të afërme. Gjithë kjo përzierje eklektike arti, është ngjizur në një compact disk, të quajtur Ballkan-Piano, dhe së shpejti është në dalje edhe një tjetër që do të quhet Balkan Bopp.

Kapidani, ka lindur në '70, në kohën kur Shqipëria ishte një fortesë graniti në breg të Adriatikut, prej nga as hyej e as dilej, në një familje arti, që do të shënojë pastaj edhe rrugën e tij në muzikë e në zhanret përkatës. Por rrënjët e familjes së tij, thellë në histori e ne gjeografinë e Shqipërisë, në krahinën e Mirditës, në historinë e lashtë të askujt më pak se Lek Dukagjinit, dhe fisit të



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 24 maj 2009.

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND

MARKELIAN KAPIDANI

Jazzi im ballkanik

vijon nga faqja 8

Gjonmarkajve, që të shquar në luftën kundër turqve ku prinin luftëtarët e maleve të veriut të Shqipërisë, morën emrin Kapedan, që mbijeton edhe kohëve të sotme.

Ndërsa muzika ka hyrë në jetën e Kapidanit që në moshë shumë të re, jazz-i ka fjetur i heshtur në partiturat e të atit, edhe ai muzikant i një Shkodre të vjetër, të përçudnuar nga vala përhumbëse e traditave që kaploi Shqipërinë bashkë me komunizmin për vite të gjata izolimi. Ndërsa pas rënies së regjimit, eksperimentimi u bë i ligjshëm, i tolerueshëm, dhe dukej se brezi i Kapidanit kishte detyrën të kryente atë që nuk ishte e mundur në vitet e gjata të izolimit. Duke rizbuluar jazz-in por duke rizbuluar edhe muzikën e larmishme e të tejpasur shqiptare e ballkanike, duke u zhytur thellë në të, dhe duke i gjetur rrënjët, ritmet, përtej klisheve që qarkullojnë rëndom, në historinë e largët e të përbashkët, të Ballkanit e Lindjes së mesme.

Por Shqipëria është e fundme, nuk mjafton për ata që duan të arrijnë të tjera horizonte, përtej borderosë së sigurt. Dhe si shumë kolegë e shokë të tij edhe Kapidani, në '97-ën e trazuar e pa veten të pavend e të pastimuluar në Shqipëri, dhe iu desh të merrte rrugën drejt shtigjeve të reja, në Itali. Duke bërë tabula rasa të ekzistencës së tij të mëparshme, siç u ndodh rëndom migruesve, e duke ndërtuar një të re, nëpërmjet një procesi të dhimbshëm, por produktiv që ka sjellë artistin e afirmuar e të suksesshëm që njihet sot.



”

Brezi i Kapidanit kishte detyrën të kryente atë që nuk ishte e mundur në vitet e gjata të izolimit. Duke rizbuluar jazz-in por duke rizbuluar edhe muzikën e larmishme e të tejpasur shqiptare e ballkanike, duke u zhytur thellë në të, dhe duke i gjetur rrënjët, ritmet, përtej klisheve që qarkullojnë rëndom, në historinë e largët e të përbashkët, të Ballkanit e Lindjes së mesme.

INTERVISTAnga **Marjola Rukaj**

Shqiptari i Italisë: Pse kjo zgjedhje për të ndërthurur muzikën folkloristike shqiptare dhe ballkanase me muzikën jazz?

Markelian Kapidani: Kryesisht është ideja për të krijuar diçka të re, që më intereson. Nuk ka muzikë që nuk mund të kombinohet me një tjetër për të arritur diçka të re. Për një pikë të tillë të fuzionit duhet njohje e madhe qoftë e folklorit qoftë e muzikës së kultivuar. Mua me interesonte folklori si rrënjë e muzikës që më përket, dhe jazz-i si shprehje e lartë e lirisë së improvizimit dhe krijimit muzikor. Këto dy aspekte i kam pasur gjithmonë me vete. Pas shumë vitesh studimi të muzikës klasike, të jazz-it dhe të folklorit shqiptar por edhe pas shumë vitesh eksperience në fusha të ndryshme të muzikës ku kam punuar më në fund arrita tek ndërthurja e këtyre botëve të ndryshme të muzikës. Është interesant fakti që vetë jazz-i lind nga folklori, i amerikanëve të zezë, që quhet pastaj edhe Blues dhe gërshetohet me muzikën e kultivuar të popullit të bardhë evropian. Unë duke njohur këto dy tradita, përdor folklorin shqiptar dhe e ndërthur atë me muzikën jazz.

Por ju jeni formuar në Shqipëri, në vitet kur kjo e fundit ishte vendi më i izoluar në Evropë. Si e keni zbuluar jazz-in?

Jazzin e kam zbuluar në moshën 14 vjeç. Im at luante rreth viteve '60 jazz, tek Kafja e Madhe në Shkodër ku kishte një orkestër të vogël. Pas viteve '60 jazz-i u ndalua në Shqipëri dhe në gjithë vendet komuniste si një muzikë amerikane, si imperialiste dhe për shkak të plot epiteteve të tjera politike. Në '84, në moshën 14 vjeç duke kërkuar mes partiturave të tim eti gjej disa revista jazz-i ku në fund të secilës nga ato kishte të shkruar nota e tema, me improvizime dhe me akorde. Në këtë mënyrë e kam zbuluar jazz-in. Jo për dëshirë të tim eti, por rastësisht, madje im atë kishte frikë - më vonë edhe ma ka shprehur këtë - ngaqë ishte muzikë e ndaluar se mos unë shkoja dhe e luaja këtë muzikë në shkollë apo në shoqëri dhe mund të na krijonte probleme.



Nisur nga fakti që Shqipëria ka dhe ka pasur shkëmbime shumë minimale me fqinjët e saj ballkanas veçanërisht nga pikëpamja kulturore dhe njerëzore gjatë 50 viteve të fundit. Si ka ardhur interesi juaj për pjesën tjetër të Ballkanit?

Kjo ka ardhur si një pjekje e personalitetit tim. Vitet e fundit duke studiuar jazz, njoha jazz-in e Karibeve, jazz-in kuban, atë të Republikës Dominikane, jazz-in brazilian që e njihja që më parë dhe kjo njohje me jazz-in e Amerikës Latine, e zhvendosi vëmendjen time në strukturat rit-

mike që muzikantët e këtyre vendeve përdorin në muzikën e tyre. Këto struktura vijnë nga Afrika, dhe si rezultat u mora edhe me studimin e folklorit afrikan, i cili më çoi tek muzika ritmike antike, të Egjiptit, dhe Marokut. Nuk është thjeshtë për tu shpjeguar por është diçka shumë interesante. Qytetërimi i Egjiptit ka ndikuar gjithë Mesdheun, Greqinë, e pastaj nëpërmjet pushtimeve të Aleksandrit të madh gjithë Ballkanin e Lindjen e mesme. Ekziston një lidhje shumë e fortë nga ana shpirtërore dhe muzikore e gjithë Ballkanit,

Jazzin e kam zbuluar në moshën 14 vjeç. Im at luante rreth viteve '60 jazz, tek Kafja e Madhe në Shkodër. Kishte një orkestër të vogël që luante jazz. Pas viteve '60 jazz-i u ndalua në Shqipëri dhe në gjithë vendet komuniste si një muzikë amerikane, si imperialiste dhe për shkak të plot epiteteve të tjera politike

dhe e Mesdheut duke përfshirë këtu edhe Spanjën, me meloditë dhe ritmet moreske, flamenkon etj. Të gjithë këto ritme e kanë zanafillën nga Afrika, ashtu siç e ka edhe jazz-i nga Afrika perëndimore, Bregu i Fildishtë. Ky udhëtim imagjinari që bëra këto vitet e fundit më solli tek Ballkani dhe tek Mesdheu dhe më bëri që të mundohem të sintetizoj folklorin e Ballkanit tek muzika ime.

Cilat janë ritmet folkloristike të Ballkanit që parapëlqeni më shumë të zgjidhni?

Është interesante sepse ritmet

vijon në faqen 12



Specialisti për fluturime charter, low cost, fluturime linje dhe tragete

- Tiranë
- Durrës
- Vlorë

Bonus për ulje çmimi prej 20 eurosh, nëse na telefonon e thua "Offerta giornale"!!!

Prenotime Fluturim, Hotel, Makina me qira, Tragete dhe Trena në Shqipëri edhe me telefon, me çmime konkurruese.

TURISADRIA VIAGGI

VIA MAZZINI 119/C 47042 CESENATICO (FC)

Tel. 0547.82492 - 0547.674221 - 340.7089484

www.volialbania.it

vijon nga faqja 11

që përdorin si shqiptarët, si sllavët, si turqit, i kanë rrënjët tek Egjipti dhe tek Greqia. Për shembull një nga ritmet më interesante është kallamatiani, që vjen nga Kallamata, një qytet bregdetar në Greqi. Nëpërmjet këtij ritmi luftëtarët vallëzonin rreth heshtës së Akilit. Apo ritmi Karsilamas është shumë i përhapur në pjesën e Turqisë dhe në Palestinë. Për shembull në muzikën folklorike shqiptare kënga "A kanë ujë ato burime" i përket këtij lloj ritmi. Apo ritmi Malfouf, që vjen nga Afrika, por e përdorin shumë edhe shqiptarët edhe sllavët në muzikën e tyre popullore. Por një pjesë e mirë e atyre që bëjnë e që merren me muzikë në Ballkan nuk i njohin këto emra as strukturat e ndërtimit të këtyre ritmeve. Siç thuhet, në të tilla raste, i bien me vesh. Nuk ekzistojnë as tekste për të tilla gjëra. Sepse askush nuk i ka studiuar në mënyrë të thellë dhe serioze. Studimi i folklorit është marrë seriozisht nga shumë pak studiues, dhe janë të rralla studimet që në të vërtetë vlejné. Pjesa më e madhe e folklorit në botë, në përgjithësi në botë mësohet nga muzikantët që krijojnë muzikë ndërsa një teori mbi zanafillën dhe zhvillimin e folklorit nuk ekziston.

Si ndodhi që u transferuat në Itali?

Ndodhi në '97-ën, në kohën e krizës së madhe. E gjeta veten në një pikë ku nuk kisha më ç' të bëja pasi gjendja në Shqipëri u degjenerua. Punoja në radiotelevizion në atë kohë në departamentin e spektakleve. U prish klima, dhe për artistin nuk ka më vend në momente të tilla. Kur njerëzit kanë probleme mbijetese për të zgjidhur, nuk është momenti i mirë për muzikën. Fillimisht në Itali kam ardhur në Milano, pastaj kam lëvizur nëpër hinterlandin milanez dhe në Venecia, ku kam qenë edhe në Caffè Quadri, një prej kafeve më të vjetra në Evropë. Mu desh ta nisja nga zeroja, mes vështirësive të ndryshme. Shumë muzikantë që kanë ardhur këtu në perëndim e kanë lënë muzikën, janë bërë bojaxhinj, muratorë, sepse muzika nuk të jep të jetosh. Ose më mirë të jetuarit me muzikë arrihet vetëm atëherë kur hyn në disa qarqe, afirmohesh dhe arrin të fitosh duke bërë muzikë.

Sa ndikim ka pasur në këto vështirësi të qenit shqiptar?

MARKELIAN KAPIDANI

Jazzi im ballkanik



Është interesante sepse ritmet që përdorin si shqiptarët, si sllavët, si turqit rrënjët i kanë tek Egjipti dhe tek Greqia. Për shembull ritmi Karsilamas është shumë i përhapur në pjesën e Turqisë dhe në Palestinë. Në muzikën folklorike shqiptare kënga "A kanë ujë ato burime" i përket këtij lloj ritmi.

Jashtëzakonisht, si për gjithë shqiptarët në ato vite, ka pasur shumë probleme, pastaj edhe vetë profesioni im kërkon që të jesh i lirë, të mos varesh nga askush. Në përgjithësi shkoja në orkestrat e sallave ku bëheshin ballot, kam punuar për pesë vjet dhe pastaj kam hyrë në disa qarë muzike më interesante, kam bashkëpunuar edhe për një album të Fausto Lealit.

Aktualisht varem nga etiketa Jazz "RED RECORDS" të zotit Sergio Veschi për të cilën kam regjistruar diskun "BALKAN PIANO". Të jesh muzikant është një punë që kërkon shumë sakrificë, më është dashur shumë durim. Por kur del përpara publikut dhe ata të duartrokasin sepse u pëlqen muzika jote, ky është maksimumi i kënaqësisë.

Po me Shqipërinë ç'marrëdhënie keni?

E vetmja marrëdhënie artistike që kam me Shqipërinë, është festivali i Jazz-it që zhvillohet në Shkodër. Shkoj gati çdo vit, rri një javë apo 10 ditë, pastaj shkoj në Tiranë për të parë prindërit e mi dhe takoj ndonjë shok muzikant për të kujtuar kohët e kaluara. Mbaj lidhje me ndonjë shok muzikant që është jashtë Shqipërisë, si për shembull me Elton Dedën që është në Amerikë. Kemi një lloj plani për të bërë diçka por mbetet për t'u parë.

E ndiqni skenën muzikore shqiptare të viteve të fundit?

Më tepër mbaj lidhjet me persona me të cilët kam pasur miqësi edhe nga ana muzikore edhe nga

ana personale mbaj lidhjet. Për sa u përket festivaleve nuk kam shumë interes, sepse me sa më kanë thënë e me sa kam parë, më duket se kanë ndryshuar pak a shumë pikësynimet artistike. Nuk janë më ato kohëra kur synonim të fusnim diçka të re, të krijojmë. Tani është ndryshe, të gjithë duan të bëhen muzikantë, të gjithë mendojnë të fitojnë para, pa u kujdesur shumë për cilësinë e muzikës që nxjerrin. Kjo përsa i përket muzikës së e lehtë, kurse muzika klasike vazhdon të jetë e lidhur me institucionet, dhe vazhdon të jetë e kontrolluar, dhe cilësore. Nuk më vjen mirë ta them por muzika e lehtë ka dalë jashtë çdo parimi.

Nga se vjen kjo?

Ndoshta nga liria e tepruar, nga dëshira për të bërë shumë, dhe veçanërisht nga padituria. Nuk mund të bëhesh artist, muzikant ose piktor pa studiuar në mënyrë profesionale për të marrë zatin. Në Shqipëri ka shumë artistë që janë diletantë. Diletantizmi është në masë në gjithë



botën. Por ngaqë ne jemi vend i vogël e ndjejmë më shumë peshën e tij, Edhe këtu në Itali ka shumë diletantë, mirëpo në një popullsi prej 60 milionësh, kjo duket më pak se në një popullsi prej vetëm tre milionësh.

Por në vitet '90 pati disa prurje të reja, muzike që më parë nuk njihesh, rock, e alternativa të tjera. Ku janë këto grupe?

Të gjithë janë shpërndarë sepse Shqipëria nuk stimulonte më. Kuptohet, lidhjet mbeten sepse është vendi i lindjes dhe nuk mund të fshihet nga kujtesa, por ekziston një pikë pas së cilës Shqipëria nuk mund të të japi më. Sepse nuk ekzistojnë as strukturat, që të të mbështesin e të të stimulojnë. Nga ana artistike, nga organizmi është shumë e varfër. Artistët e vërtetë nuk mund të joshen. Ka artistë shumë të mirë, por ata që arrijnë një farë pikë, pastaj flenë me atë që kanë arritur sepse mungojnë stimujt, ballafaqimet me të tjerët me prurjet e reja, nëpër festivale apo koncerte. Po të kishte një

vijon në faqen 14

DAL 30 MARZO AL 11 APRILE



LA SPESA INTELLIGENTE

Insalata di mare con verdure g 500 x 2 ~~6,39~~

5,69

Salmone rosso sockeye selvaggio Alaska g 100 al kg Euro 29,90 ~~3,39~~



2,99

Filetto di platessa g 500 al kg Euro 8,54 ~~3,99~~



2,99

Lavapavimenti con 2 alcool ml 1.500 al L Euro 0,46 ~~0,85~~



0,69

... E ALCUNI ESEMPI DEL NOSTRO ASSORTIMENTO

Yogurt cremoso frutta assortita g 1.000



1,99 cad.

Caramelle latta Cambridge assortite g 200 al kg Euro 5,45



1,09 cad.

Filetto di cernia g 400 al kg Euro 10,25



3,69

Ammorbidente concentrato ml 750 al L Euro 1,32



0,99 cad.

EUROSPIN IL PIÙ GRANDE DISCOUNT ITALIANO CON OLTRE 750 PUNTI VENDITA PER CONOSCERE IL TUO PUNTO VENDITA PIÙ VICINO, VISITA IL NOSTRO SITO WWW.EUROSPIN.IT

L'offerta è limitata all'assortito di quantitativi ad uso familiare.
Descrizioni e prezzi validi salvo errori tipografici ed omissioni di stampa.

vijon nga faqja 13

klime të tillë në Shqipëri, 80% e tyre që mendojnë se sot bëjnë muzikë do të merrnin kazmën për të hapur kanal në vend që të bënin muzikë!

Kjo vlen edhe për Festivalin e dhjetorit?

Po normalisht. Një pjesë e muzikantëve (siq e thashë edhe më parë), flenë sepse kanë arritur një siguri ekonomike, dhe nuk kanë stimul artistik. Një pjesë kanë ikur nëpër botë, dhe ka mbetur një brez i ri që është duke u formuar tani i cili nuk ka studimet e duhura dhe përgatitjen e nevojshme për të bërë muzikë. Bëjnë prodhime me ritme të gatshme, nuk ia kanë idenë arranzhimit dhe prodhimet pastaj dalin si qoftet ne qe-baptore.

Një fenomen shumë interesant i kohëve të fundit, është për shembull nacionalizmi, patriotizmi, qoftë në muzikën e lehtë qoftë në atë popullore. Madje në festivalin e dhjetorit, ndër këngët fituese ishte edhe ajo e West side family, hip hop nationalist... është interesant fakti që i njëjti fenomen është shumë i pranishëm edhe në Serbi, Maqedoni, Kroaci etj, vende të Ballkanit.

Këto janë fenomene që ndodhin. Duhet të ndodhin sepse ekziston së paku arsyeja e momentit ku këto fenomene marrin jetë, dhe këto forma artistike janë pasoja. Por gjenerata e re është e pashkolluar. Rap-i lind nga brezi i ri i zezakëve, të pashkolluar, të emargjinuar dhe është më e thjeshtë për tu asimiluar e për tu kënduar nga ai që e dëgjon. Unë nuk do ta quaja muzikë, por thjesht tekst i recituar në një farë mënyre. Për sa i përket rap-it lidhur me nacionalizmat e ndryshme, nuk ka një shkak social të fortë, se sa është më shumë një formë e thjeshtë për tu afirmuar. Kush bën tekste të tilla ia arrin qëllimin me rrugën më të thjeshtë. Si përfundim nuk më duket se këto këngë kanë domethënie të rëndësishme politike.

Po a duhet lejuar që një zhanër i tillë, të hyjë e të fitojë në festivalin e dhjetorit?

Festivalet e këngës janë muzikore. Ato janë të lidhura me tekstet dhe poezinë, me arranzhimin por edhe me situatën politike. Kur unë punoja në radiotelevizion kërkonim që ata që sillnin këngë, të mos përmbanin



MARKELIAN KAPIDANI

ekstremizma, mundoheshim t'i limonim. Për të vetmin fakt sepse festivali nuk është politikë. Nëse dikush dëshiron të bëjë politikë nëpërmjet muzikës mjafton që të nxjerrë një disk. Kurse festivali është një shfaqje e muzikës së lehtë, ndërthurur me poezinë lirike kryesisht. Prandaj jam kundër këtyre shtysave.

Megjithatë në Shqipëri ka edhe disa prurje interesante të viteve të fundit, Festivali i Jazz-it të Shkodrës, ai i Tiranës... Si i vlerësoni këtë lloj fenomeni të ri?

Fenomeni është sporadik. Është shumë i mirë, por janë këto dy fenomene që janë të izoluar dhe nuk kanë jehonë. Fuqia ekonomike e këtyre festivale do duhej të mbështetej nga bashkitë, për të pasur një pjesëmarrje edhe më të madhe. Përse jazz-i të ngelet njohje e vetëm një elite? Këtë muzikë duhet ta njohë edhe populli, për këtë nevojitet përkrahja. Ashtu si dikur ekzistonin festivalet, ku merrnin pjesë orkestra e ansamble, si për shembull dikur festivali i Gjirokastrës. Këto manifestime do duhej të krijoheshin edhe për Jazz-in, koncerte, muzikë në shesh ... Ashtu siç bëhej festivali i pranverës jashtë nëpër gjithë Shqipërinë, mund të bëhet kështu një iniciativë nëpër të gjitha qytetet kryesore. Një ngjarje e tillë do të gjallëronte jetën artistike, të njerëzve. Është interesant fakti që në Shqipëri nuk ekzistojnë festat e komuniteteve. Si në Itali, në Gjermani, në këtë pjesë të Evropës ekziston festa e birrës, festa e verës, e kështu me radhë. Këto, në Shqipëri nuk ekzistojnë. I vetmi moment kur shqiptarët mblidhen të festojnë së bashku është nëpër dasma. Kjo të bën të mendosh se ne shqiptarët nuk jemi shumë dashamirës me njëri-tjetrën, nuk kemi vende të përbashkëta, ku të shoqërohemi e të festojmë. Problemi është komunizmi, humbja e traditave që më parë duhet të kenë ekzistuar.

Cilat janë projektet për të ardhmen, pas diskut të parë Balkanpiano?

Do të nxjerr albumin tim të dytë Balkanbop për etiketën RED RECORDS. Ky disk i përmbahet një stili jazz shumë të ngrohtë

amerikan të viteve '40, '60. Tani kam dëshirën të ndërthur këtë lloj jazz-i të ngrohtë me ritmet folkloristike të Ballkanit. Kjo është sfida ime e momentit.

Bën pjesë Shqipëria në projektet tuaja, edhe për të kontribuar në këtë drejtim?

Bën pjesë vetëm në mënyrë sporadike. Unë marr pjesë rregullisht në Festivalin e Jazz-it në Shkodër. Në 2010 do të marr pjesë në një turne të një orkestre spanjolle që do të ndalet edhe në Shqipëri. Kam disa ide për të bërë diçka në Tiranë por problemi është gjithmonë tek mënyrë se sis bëhen gjërat. Në Shqipëri ekziston një menefregizëm i tmerrshëm. Gjithçka bëhet me ritme shumë të ngadalta, shumë të paorganizuar. Prandaj jam gjithmonë shumë i tërhequr përpara propozimeve që kanë të bëjnë me Shqipërinë. Por do të më pëlqente të bëja disa koncerte në Shqipëri.

Çfarë lloj muzike dëgjonit para se të binte sistemi?

Unë gjithmonë kam dëgjuar jazz, përveç muzikës klasike që e studioja në shkollë. Me shumë vështirësi kuptohet, sepse duhej dëgjuar fshehurazi. Kam pasur një magnetofon në shtëpi dhe regjistroja, festivalin e Sanremos, që në atë kohë na dukej si i një cilësie të jashtëzakonshme. Pastaj në atë periudhë, regjistroja emisionet muzikore të kanalit 1 të Jugosllavisë, apo të Rai 1. Jugosllavia ka pasur traditë jazz-in, kishte emra të rëndësishëm, që kishin krijuar një lloj zhanri të tyre. Në atë periudhë Rai ishte shumë më i mirë nga ç'është tani, koncertet ishin cilësore. Unë i regjistroja, pastaj i dëgjoja dhe i analizoja sërish. Pastaj materialet më të mëdha erdhën rreth viteve '90, '91, '92. Kur kam dalë për herë të parë jashtë shtetit kam pasur mundësi të marrë disqe e libra që tek ne nuk gjendeshin.

Në vitet '90, pati një ringjallje të muzikës, erdhën Elita 5 nga Maqedonia, Agron Berisha nga Kosova, të tjera grupe u krijuan në Shqipëri. Çfarë shijeje ju ka lënë ajo periudhë?

Ka qenë një periudhë shumë e bukur. Me shumë dëshirë për të bërë muzikë, gjithkush kishte dëshirë për të realizuar diçka, për të shtuar pjesën e vetë në muzikën shqiptare pas hapjes së Shqipërisë. Për sa i përket muzikës së lehtë pjesa më e madhe ishte e etur për rock. Erdhi Agron Berisha, doli Elton Deda,

”

Do të nxjerr albumin tim të dytë Balkanbop, që i përmbahet një stili jazz shumë të ngrohtë amerikan të viteve 40, '50. Tani kam dëshirën të ndërthur këtë lloj jazz-i të ngrohtë me ritmet folkloristike të Ballkanit. Kjo është sfida ime e momentit.


Aleksandër Gjoka. Ka qenë një periudhë shumë krijuese që më ka vlejtur nga ana profesionale sepse duke punuar me këngëtarë rock kam pasur mundësinë të zbuloj shijet muzikore të tyre, prurjet e tyre dhe kjo më ka vlejtur nga ana profesionale. Sot nuk ekziston më ajo valë. Në atë kohë, në vitet '90 dëshira për të bërë diçka e kalonte dëshirën për të fituar, gjë që është gabim sepse muzikanti për të bërë muzikë cilësore duhet t'i kushtohet asaj, dhe të jetë i përgatitur prandaj duhet edhe të fitojë jetesën me të bërit muzikë. Sot është e kundërta. Muzika është e cilësisë së dobët dhe qëllimi kryesor është shitja e saj, pa shumë kujdes për cilësinë. Nuk më pëlqen atmosfera e sotme.

Duke i parë me syrin e tan-

ishëm, sa cilësi kishte ajo lloj skenë? Për atë periudhë ndonjë rocker kosovar thotë "shqiptarët e Shqipërisë nuk marrin vesh nga rock-u"...

Problemi është se sa nga muzikantët që mendojnë se janë të tillë, dinë dhe kanë studiuar duke fituar njohuritë e duhura për të bërë atë lloj muzike. Në Shqipëri ekzistojnë muzikantë që mund mos njohin elementet teknike, por kanë dëgjuar aq shumë rock sa që janë rocker brenda. Për shembull Aleksandër Gjoka, është rocker brenda, edhe pse mund të mos jetë ekspert i arranxhimit. Ka pasur cilësi por ata pak që kanë qenë kanë ikur. Për sa i përket kosovarëve, ata këngëtarë që vërtetë vlejnë nuk janë të njohur siç do të meritonin. Muzikantët e Kosovës kanë pasur mundësi të njohin elementët elektronike

vijon në faqen 17



www.aloartdance.com
aloart
Dance

il vestitario pensato per le scuole di danza

aloart
Dance

Mobile +39 334 7621125
Fax +39 02 700 438 165
e-mail: info@aloartdance.com

www.aloartdance.com

la qualità aloart
Dance
al prezzo giusto...



Presenti in DANZA in FIERA
Padiglione Spadolini - Piano Attico Stand O1



Comune
di Fermo



Comune
di Porto San Giorgio



ACADEMY

GISELLE

DANZA E MUSICA



JOE ARTID FEJZO • GISELLE DANZA E MUSICA

Firmum Dance Festival

Villa Vitali - Fermo - Italy

5-12 Luglio 2009

Porto S. Giorgio in Danza

Workshops - Porto San Giorgio (FM) - Italy

www.crystalofdance.com

PORTO SAN GIORGIO
Filiale di MONTEGRANARO
Tel. 0734.672051 - 328.6136499

info@giselle.it
www.giselle.it

vijon nga faqja 15

para nesh duke qenë të hapur me botën, ndërsa ne ishim plotësisht të izoluar. Për të qenë rocker duhet të kesh disa karakteristika vokale tipike për këtë lloj muzike. Jo të gjithë këngëtarët e kanë këtë cilësi. Ndoshta kosovarët e dinë këtë gjë dhe për këtë arsye janë më bindës në këtë stil. Ne, shumë nga këto njohuri muzikore i arritëm me vonesë.

Ndërsa për sa i përket cilësisë së tanishme të muzikës, duhet thënë se muzika e lehtë (si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë), po përjeton një periudhë pasigurie artistike të përgjithshme. Kopjohet gjithandej për të prodhuar "klone" muzikore, pa fantazi dhe originalitet. Do të isha i lumtur sikur Rock-u shqiptar të bëhej i famshëm edhe jashtë atdheut, por për të arritur një rezultat të tillë nevojitet një jetë artistike më e gjallë dhe një kultivim më i gjerë i ambienteve muzikore.

Është interesante, që në të gjitha biografitë tuaja përmendet fakti se jeni pinjoll i familjes së Markagjonajve, pra i Lekë Dukagjinit. Çfarë do të thotë kjo për ju?

Unë jam "Soktar i vuajtur". Hahh ...

Familja ime është një nga familjet e vjetra që daton që në 1100-ën. Nga pikëpamja historike është shumë e pasur, por nga pikëpamja materiale kjo familje e madhe është plaçkitur nga komunistët. Familja e GjoMarkajve është një nga dyert më fisnike të mbarë Shqipërisë.. Jam shumë i lumtur, sepse në një farë mënyre ndihem pjesë e historisë tonë. Fisnikëria është një cilësi që nuk trashëgohet. Janë gjetet personale të cilat e fisnikërojnë individin, kështu që, fisnik mund të quhet edhe një person që vjen nga shtresat e varfra të shoqërisë, Si rrjedhim, koncepti i fisnikërisë ka një kuptim më të gjerë se sa trashëgimitë e titujve familjare. Më pëlqen që historia e familjes sime është një pjesë e rëndësishme e historinë së Shqipërisë.

Por unë sot jetoj me celular, me kompjuter, me fjalën e fundit të teknologjisë, kohët evoluojnë. Ndërsa nga Lek Dukagjini ka ngelur më tepër Kanuni, që është një problem sot në 2009-ën. Kush ka lexuar të drejtën romane, vëren një ngjashmëri të jashtëzakonshme me kanunin e Lekë Dukagjinit, por në kundërshtim me realitetin ku zhvillohej e drejta romane, dhe ku zhvillohet sot ka-



nuni. Është absurditet që kanuni zbatohet ende. Do të kishte logjikë në Mesjetë por jo sot. Kjo tregon se në Shqipëri nuk ka ekzistuar një shtet i vërtetë, që të drejtonte gjithë popullin shqiptar. Kjo e ka detyruar shqiptarin të lidhet me kanunin (duke e interpretuar atë në mënyrë sa personale po aq edhe të gabuar) dhe të bëjë drejtësi vetë, vetë zot e vetë shkop. Kjo më indinjon sepse një gjë e tillë shpreh vetëm padituri.

Nuk duhet harruar fakti se Dera e Gjomarkajve thërritet nga populli "Reza e Kanus", pra: familja e cila qëndron në bazën e Kanunit si trashëgimtare e drejtpërdrejtë e Lek Dukagjinit i cili e formuloi Kanunin. Tek neni 150, paragrafi 1126 i Kanunit thuhet: Dera e Gjomarkut asht themeli i Kanus... Dhe më poshtë... 1131: Përtej kësaj dere s'ka vazhdim çashtjesh... 836: Është në kundërshtim me Kanunin kushdo që hakmerret mbi gratë dhe fëmijët ... Apo

1154: Kreu i një fisi nuk ka të drejtë të djegë, të çrrënjosë ... apo të detyrojë të tjerët në mërgim.

Nga vetë Kanuni rrjedh që: kush kërkon ta zbatojë atë në mënyrë "personale" e pa respektuar përmbajtjen e tij, shkel ligjet e vetë Kanunit i cili pa Familjen e Gjomarkajve nuk ka mundësi të drejtë zbatimi. Kush vepron në këtë mënyrë të pandërgjegjshme sot, është dyfish fajtor, karshi ligjit të shtetit demokratik shqiptar dhe karshi Kanunit. Kanuni i Lekës është mesjetar, ka vlerë legjislative vetëm për një shoqëri mesjetare.

Por më mesjetarë më duken ata persona që mundohen akoma sot të vendosin drejtësi nëpërmjet Kanunit në të shumtën e rasteve pa e njohur aspak atë! Sot vendi i kanunit është në muze, në librat e historisë apo në veprat e artit. Jeta e qytetarit shqiptar duhet t'i bindet ligjeve të një shteti

demokratik. Për këtë arsye u takon të ndërhyjnë me dinamizëm organeve kompetente të shtetit shqiptarë për të zbatuar "ligjin", për të dalë herë e përgjithmonë nga tuneli i mesjetës dhe për tu drejtuar nga Europa e qytetëruar moderne.

Në përgjithësi malazezët krenohen me origjinat e tyre që i llogarisin nga prijësit mesjetarë si Lek Dukagjini, apo Gjergj Kastrioti. Fenomeni është shumë interesant. Ju si e vlerësoni?

Nuk kanë pasur motiv tjetër përveç Lekë Dukagjinit, apo Gjergj Kastriotit, ishin figura e princit, e dukës, kapedanit, fjala e të cilit ishte ligj bashkë me fjalën e zotit.

Sot, në epokën moderne jeta ecën me hapin e kohës dhe ligjet e dikurshme i lënë vendin ligjeve të reja që i përkasin kohës sonë.

Bisedoi Marjola Rukaj

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHQIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetmi zë në gjuhën shqipe në shtypin italian.

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëm sajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE

apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUdhË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërko të të nisim numrin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Me ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.

Kursen 20% nga çmimi në
pikëshijet e gazetave
- Gazeta të mbërrin drejt e në
shtëpi pa asnjë shpenzim
të mëtejshëm

BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

Pas shume vitesh pune e suksesi në Itali, pas shumë eksperiencash të grumbulluara në evenimente kombëtare e ndërkombëtare, skulptori Genti Tavanxhiu në bashkëpunim me qendrën e kulturës "Vangjush Mio", Korçë ri-sjell në qytetin e Korçës Simpoziumin e skulpturës. Themi risjell për faktin që këtë aktivitet skulptori e solli për herë të parë në këtë qytet vitin e kaluar i mundësuar nga bashkëpunime me entet lokale dhe që u mirëprit nga pjesëmarrësit por dhe nga publiku i shumë që ndoqi me interes të veçantë gjithë etapat e punës së skulptoreve gjatë realizimit të veprave në periudhën e zhvillimit të Simpoziumit.

Skulptori shkodran Genti Tavanxhiu është një nga shqiptarët e Italisë, i mirënjohur me arritjet e tij në fushën e skulpturës monumentale, i vlerësuar në ekspozita e simpoziume kombëtare e ndërkombëtare me vepra të përshërshme të shpërndara anë e mbanë, i cili ka vendosur paralelisht me aktivitetin e tij krijues të ndërmarrë e të konsolidojë bashkëpunime me institucione kulturore e artistë shqiptarë për krijimin e evenimenteve artistike me karakter kombëtar e ndërkombëtar duke vënë në dispozicion eksperiencën e tij në këtë fushë. Një mundësi "rritje" për institucionet e kulturës shqiptare nga ky bashkëpunim e një shprehje bujarie e transferimit të kësaj eksperiencë nga ana e artistit.

"Një laborator i tille është shumë i rëndësishëm për një artist - thekson Genti Tavanxhiu - ndihmon në promovimin e punës dhe në konfrontimin e saj me punime të artisteve të tjerë, pasi të gjithë kemi nevojë të shkëmbejmë të reja".

Simpoziumi i Ndërkombëtar i skulpturës në 2008, në qytetin e Korçës u manifestua para publikut me veçantinë e tij si spektakël i artit figurativ "a cielo aperto".

Falë njohjes së tij me skulptorë nga vende të ndryshme të Botës, Genti Tavanxhiu solli në këtë simpozium artistë si Chifu Panaitë nga Rumania, i cili ka punoi në gur një forme asteroidi me mesazhe të kodifikuara (artisti ka fituar çmimin e parë në Biennale-n e Toyamures, në Japoni), një gjë shume e rëndësishme kjo në panoramën e artit bashkëkohor. Jo kley nga Gjermania, i cili punon me një projekt të quajtur qytetet e Kley-t, dhe erdhi në këtë aktivitet nga çmimi I i fituar në Simpoziumin madhështor të Dubait. Uli Scwander, Gjermani-Spanje (filozof), i cili me licencë poetike gdhendi "Tavolina e kohës". George Cpajak nga Serbia, një nga



Genti Tavanxhiu mbledh skulptorët në simpozium në Korçë



veteranet e simpoziumeve internacionale, i cili punoi një obelisk të gjatë 4m. Toshihiko Minamoto, Japoni, një mjeshtër i madh i të quajturave "Metamorfozat e Hesh-tjeve" si dhe artistë shqiptarë të cilët punuan duke ruajtur traditat e shkollës shqiptare. Emanuel Koko nga Gjirokasta, i cili i bazuar në një punë me motive folkloristike huazoi nga gunat. Vladimir Kaçaku, drejtor i muzeut "Bratko" në Korçë, që kërkonte të zgjidhte problemin e përshërshëm të skulpturës në lidhje me raportin e formave dhe estetikën e tyre në hapësirë.

Zhvillimi i tij u bë në një ambient të predestinuar nga bashkia e qytetit të Korçës dhe mundësoi qytetarët të bëhen spektatorë në çfarëdo momenti të punës së skulpturës, të shikojnë se si artistët një copë trung peme, një copë gur etj. e transformonin pak nga pak në një vepër arti. Por ky ishte vetëm njëri nga aspektet e Simpoziumit mbasi zhvillimi i tij konsiston kryesisht në punën e skulptorëve në kontakt të ngushtë njeri me tjetrin e përballje me të përditshmen, nga ky aspekt artistëve shqiptarë iu krijua mundësia e krahasimit të dijeve qoftë në aspektin teknik e teorik si dhe eksperiencash në vite. U krijuan njohje e miqësi të reja të cilat mund të kthehen në të ardhmen në bashkëpunime serioze, eksperiencë të reja apo thjesht miqësi mes artistëve e qytetit.

Simpoziumi i skulpturës i 2008 në Korçë, falë impenjimit serioz dhe të autoriteteve lokale, të cilat mundësuan të garantohej siguria e ambientit të punës arriti të ketë një sukses të madh aq sa një spektakël i tillë së shpejti do të rikthehet sërish në qytet, me iniciator-kuratorë një nga "shqiptarët e Italisë" skulptorin Genti Tavanxhiu dhe bashkëpunimit të paçmuar të bashkëshortes së tij Blerina Tavanxhiu.

(Al. Te.)

Intervista me skulptorin Genti Tavanxhiu, në prag të Simpoziumit të Dytë Ndërkombëtar të Skulpturës në Korçë, Shqipëri.

Si lindi ideja e realizimit të një Simpoziumi Skulpture në Shqipëri dhe kush e mbështeti organizimin e tij?

Ideja e Simpoziumit të Skulpturës, nuk është e re. Ka vite që ky aktivitet i rëndësishëm ndërkombëtar, që përmban vlera, po zhvillohet pothuajse në të gjitha vendet e Botës me sukses.

Simpoziumi në qytetin e Korçës lindi para një viti, pasi Qendra e Kulturës "Vangjush Mio", me drejtorin e saj artistin Vladimir Topi, u interesuan për të zhvilluar një eveniment të tillë. Ato nuk kishin eksperiencë në këtë fushë dhe kërkuan ndihmën time.

Së bashku, për një kohë shumë të shkurtër brenda një muaji kemi "ngritur në këmbë" simpoziumin, fale kjo edhe miqësisë që me lidhte mua me artistë në vende të ndryshme të Botës. Në simpoziumin e parë kanë marrë pjesë artistë ma famë botërore, duke ngritur nivelin e këtij aktiviteti në ranje të larta artistike. Dua të theksoj këtu se mbështetje të madhe dhe të pakufizuar na dha Kryetari i Bashkisë në Korçë z. Niko Peleshi, të cilin gjej rastin ta falënderoj. Ai është një politikan, një njeri me një vizion për të ardhmen sepse duke promovuar Simpoziumin e skulpturës, për herë të parë në Historinë shqiptare, po kontribuon për ngritjen e Muzeut të Artit Bashkëkohor, duke

vijon në faqen 20

**FUCECCHIO
 GRUAJA SHQIPTARE NË "POPOLI UNITI"**

Me rastin e Festës Ndërkombëtare të Gruas, Shoqata kulturore "Popoli Uniti" organizoi mbasditen e të dielës 8 mars 2009, aktivitetin me titull "Gruaja shqiptare mes së kaluarës dhe të tashmes" në Auditorin "La Tinaia", Parco Corsini në Fucecchio (FI). Ishin të pranishëm në këtë aktivitet gra e vajza emigrante shqiptare por dhe nga ventet e tjera të botës, përfaqësuese të shoqatave kulturore të emigrantëve në zonë, miq e dashamirës. Mori pjesë dhe përshëndeti aktivitetin edhevetë kryetari i Bashkisë Fucecchio. Diskutimin mbi pozicionin e gruas shqiptare dje e sot e mbajti Mimoza Koja. Më pas aktiviteti mori ngjyrat e vërteta festive nga Koncerti i këngëtarit dhe instrumentistit Ferdinand Bjanku, i cili i dhuroi publikut si buqetë me lule për këtë festë një seri këngësh popullore shqiptare, këngë të lehta italiane e krijime të autorit të cilat u duartrokitën nga publiku. Sukses shënuan kryesisht duetet Bjanku-Koja në interpretimin e këngëve të bukura shqiptare. Aktiviteti përfundoi me një koktej të ofruar për pjesmarrësit nga organizatorët. (al.te)



Salla ndjek këngët shqiptare të duetit Koja-Bjanku

regjistruar memorien historike të qytetit, format e ndryshme të shprehjeve artistike edhe duke mundësuar eksperimentet për funksionin që ka vepra e artit në hapësirat e reja urbane. Ky është edhe qëllimi i këtij simpoziumi.

Organizimi i këtij simpoziumi mbështetet plotësisht nga Qendra e Kulturës "Vangjush Mio", e cila varet nga Bashkia e Korçës. Mbështetje intelektuale i ka dhënë këtij simpoziumi edhe regjisor i njohur shqiptar, Llasi Serbo.

Ky bashkëpunim është eksperiencia e parë me një institucion shqiptar?

Kjo ishte hera e parë që një institucion shqiptar bashkëpunon për një eveniment të tillë. Është një lajm i bukur dhe historik për Shqipërinë dhe shqiptarët, pasi ky eveniment ndihmon për njohjen dhe informacionin e azhurnuar të vlerave të artit bashkëkohor në Shqipëri dhe anasjelltas, për promovimin e saj në Botë.

A mendoni që një eksperiencë e tillë mund të përsëritet edhe në qytete të tjera p.sh në atë të Shkodrës ku keni lindur?

Po punojmë për të realizuar

Genti Tavanxhiu mbledh skulptorët në simpozium në Korçë

vijon nga faqja 19



këtë projekt edhe në qytetin e Shkodrës. Aktualisht me Galerinë "Iris", me drejtorin e saj, artistin Sytki Brahimi po përgatisim skedën për të prezantuar Simpoziumin e Parë Internacional në këtë qytet, duke shpresuar që ky qytet më rëndësi të madhe për kulturën shqiptare, të interesohet për promovimin e tij. Ka vite, për të mos themi kurrë, që në Shkodër nuk zhvillohet një eveniment i tillë, mbase do të shërbejë për rizgjimim e Madh.

Ç'vend zënë artistët e rinj në këto Simpoziume?

Artistet e rinj në këto Simpoziume akoma nuk kanë një rol. Po punojmë edhe në këtë drejtim. Aktualisht jemi të interesuar të pasurojmë simpoziumin e Korçës me një numër të konsideruar artistësh profesionistë, që vijnë nga vende të ndryshme të botës. Sapo të jetë formuar ky fond, do të krijohet mundësia për përfshirjen e artistëve të rinj, qofte ato edhe studente të Akademisë së Arteve. Kështu mund të investojmë në krijimin e talenteve të reja, në promovimin e tyre përkrah emrave të mëdhenj në botën e artit. Pastaj nuk përjashtohen në të ardhmen

CAMPI BISENZIO
"DONNE DELL'ARTE IN TOSCANA"

Një ekspozitë kolektive mbledh me rastin e 8 Marsit artistet e arteve figurative që jetojnë në Toskanë, mes tyre edhe piktorja shqiptare Zafina Vasa.

"Donne dell'Arte in Toscana" ku morën pjesë artiste italiane e të huaja, që jetojnë në këtë rajon u mbajt në Sala Congressi Klass të West Florence Hotel, Campi Bisenzio (Firenze).

Pas ceremonisë së inaugurimit, gazetari i Tv Toscana, Fabrizio Borghini e Filippo Lotti prezantuan katalogun "Donne dell'Arte in Toscana" i cili i prit me interes nga të pranishmit e shumë të që kishin prenotuar e ardhur posaçërisht për këtë veprimtari.

Zafina Vasa, e vetmja piktoreshë shqiptare e ftuar në këtë aktivitet kishte sjellë një nga pikurat e fundit të saj ku fiksohej mes ngjyrave në ambient ujqor një moment i gjimnastikës artistike femërore ku eleganca e lëvizjes së trupit të gjimnastes që kryen ushtrimin, i mbajtur pezull nga duart e kolegeve duket se kërkon të shprehë mes ngjyrave bukurinë femërore, praninë dhe ritmin e përsëritjes dhe të pranisë së saj kudo ku ekziston femra.

Shoqëruan veprimtarinë tingujt muzikorë të pianistes Giovanna Pontoni, baleti i artistes Natalia Bonechi e performacat e body painting të artistes Paola Vallini me modelen Noemi.

Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 5 prill 2009. (al.te.)



Piktorja shqiptare Zafina Hasa gjatë veprimtarisë

mundësia e një simpoziumi të ndërtuar vetëm nga artistë të rinj.

Ç'kriterë keni përdorur në përzgjedhjen e artistëve dhe nga cilat vende do të mbërrijnë pjesëmarrësit e Simpoziumit të dytë në Korçë?

Simpoziumi ka karakter ndërkombëtar, sepse vetëm kështu ai shfaq vlerat e vërteta. Jemi munduar të ftojme në përgjithësi artistë me karakter hibrid, d.m.th. artistë të lindur në një vend dhe që aktualisht jetojnë në një vend tjetër. Këta artistë kanë përzier kulturën e tyre me traditat e vendit ku jetojnë, duke shfaqur situata befasuese. Janë pikërisht këto epiqendra e interesimit tonë.

Kam menduar shpeshherë ta titulloj Simpoziumin e Korçës "Hibrid fantastik, në gjuhë dhe në formë"....

Deri tani, për simpoziumin e dytë janë të interesuar shumë artistë kubanë, gjermanë, anglezë, suedezë, rumunë, egiptianë, turk, japonezë, italianë, bullgarë, spanjollë dhe natyrisht jemi duke regjistruar kandidaturat.

Ju vetë si artist keni marrë pjesë në disa Simpoziume ndërkombëtare.

Mund të rrëfeni një nga eksperiencat e fundit tuajat?

Unë kam qenë pjesëmarrës në 20 simpoziume ndërkombëtare, dhe kam sjellë eksperiencat e mia në simpoziumin e Korçës si kurator artistik i tij, duke përzgjedhur artistët, që vijnë në Shqipëri.

Simpoziumi i fundit ku kam marrë pjesë u zhvillua në Universitetin e Antalias (Turqi) dhe punimi im u vendos përpara godinës së Rektoratit. Një pozicion ky me prestigj të rëndësishëm e vlerësim për mua si skulptor.

E rëndësishme ishte për mua edhe vizita në Antalya. Muzetë e artit plot me skulptura antike greke, romake, qytetet e lashta prej mermeri, natyrisht edhe peizazhet e bukura bregdetare ia shtuan vlerën vizitës sime atje. Në shume raste simpoziumi i skulpturës i shërben artistit si pushime dhe i jep mundësinë atij të njohë një vend të ri. Uroj që edhe simpoziumi i dytë ndërkombëtar i Korçës të shërbejë edhe si promovim i qytetit dhe i Shqipërisë nëpërmjet prezantimit e njohjes që do realizojnë artistët e huaj pjesëmarrës.



Është më kollaj të fitosh në SuperEnalotto se sa të lindësh me fat.



Fati është njësoj për të gjithë. Mjafton të luash SuperEnalotto, çdo të martë, të enjte e të shtunë. Mos prit më, kërkoje fatin tënd në të gjitha lokalet Sisal (ricevitoria) ku luhet lotaria.

Luaj sot. Bëhu milioner.



LA QUARTA PARETE sjell në skenë "Ditën e verës"

Janë rikthyer vetëm pas më pak se një viti, shqiptarët e teatrit bashkëkohor të Trentos.

Albert Dedja, dhe Dardana Bërdyna. Me kompaninë e tyre teatrale La quarta parete, kanë ardhur këtë herë me një tjetër iniciativë, më universaliste, që shkon përtej shqiptarisë, e përtej emigracionit kategorizues, e në të vërtetë izolues. Pjesa e interpretuar këtë herë me artin recitues të Dardanës dhe të kolegëve të saj trentinë, dhe artit skenografik të Albertit, është marrë nga një nga penat më interesante të dramaturgjisë bashkëkohore, polakut Slawomir Mrozek. Titullohet "Ditë vere", pjesa e ndërtuar mbi paradoksalen, tragjiken e komiken e jetës, shprehur me ndërthurjen e arteve recitale e pamore si edhe në iniciativën e mëparshme të trupës. Në skenë shfaqen dy aktorë, dy njerëz që takohen rastësisht në një vend të papërkufizuar, ndërsa të dy kanë shkuar aty për të kryer vetëvrasjen, secili me arsyet e veta bindëse e të lëkundshme për të lënë këtë botë. Por jeta thonë pothuaj gjithë filozofitë, e gjithë fetë botërore, është e paparashikueshme, e në mos lumturi, sjell diçka interesante, dhe pikërisht në vendin e zgjedhur për ti lënë lamtumirën kësaj bote, kalon një femër, që i bën dy personazhet të harrojnë vdekjen, e madje t'i jepen më jetësorit prej instinkteve njerëzore, gjuajtjes së një gruaje, e kacafytjes për të njëjtën grua. Gruaja është shqiptarja Dardana Bërdyna, që vjen aty duke rrezatuar sharmin femëror që ka dashur të përcjellë autori polak. Pjesa është shfaqur disa herë në Trento, duke iu shtuar kështu reperitorit të trupës teatrore shqiptaro-trentine, që me siguri nuk do të mbetet me kaq. La quarta parete, trupa e formuar para pak kohësh nga çifti shqiptar Bërdyna-



Momente nga shfaqja "Ditë vere" e Slawomir Mrozek

Dedja, është duke u afirmuar kështu në skenat e teatrit bashkëkohor italian, duke ofruar shtysa për të reflektuar jo vetëm për shqiptarët, e publikun e interesuar për fenomenin e migruarëve, por edhe për një publik shumë më të gjerë, në tema universaliste që bashkojnë njerëzit përtej kategorive brenda të cilave ata mund të shohin njëri-tjetrin.

ma.ru.

di Irene Alison, D di Repubblica, marzo 2009

Foto di Gianni Troilo

Alberti dhe Dardana zbarkuan një ditë marsi. Ishte 1991, dhe në Shqipëri njerëzit push-tonin portet në kërkim të një shpëtim nga policia që ngarkonte njerëzit nga turma. Në atë turmë, ishin ehe ata. Disidentë të lëvizjes për demokraci dhe emigrantë të rastësishëm. "Po të na kishin kapur do të kishim vënë jetën në rrezik. Kështu që hipëm në anijen e parë që gjetëm" tregon sot Alberti. "Nuk ishim duke ndjekur ndonjë ëndërr, thjesht ishim duke ikur". Atë ditë marsi në portin e Brindisit, erdhën me pak plaçka. Ai kishte xhep një copë gazete sa për t'i shkruar një letër të atit (Më fal nuk munda të të njoftoja...) ndërsa ajo me një skenar në çantë dhe origjinën të shkruar në emër: Dardan, si krahina e të parëve të saj në Kosovë. Ajo aktore, ai skenograf, të rritur së bashku duke luajtur hapadollapa nëpër rrugët e Durrësit, duke i kënduar lavde komunizmit të Enver Hoxhës, në bankat e shkollës, dhe pastaj duke studiuar në Akademinë e Tiranës, e duke mësuar demokracinë në librat e ndaluar nga sistemi. Dardana Bërdyna dhe i shoqi Albert Dedja janë vetëm dy nga 420 mijë shqiptarët (sipas dosjes së fundit të Caritas/Migrantes) që banojnë në Itali. Komuniteti i dytë i migruarëve për nga numri (pas rumunëve), që për shumë vite ka qenë i pari në listën e denoncimeve penale për krime të rënda, shqiptarët sot, përbëjnë numrin më të lartë të studentëve universitarë (10 mijë) të regjistruar në fakultetet italiane. Burra dhe gra të ardhur nga 1990 e këtej, secili me arsyen e vet për tu nisur, secili me historinë e vetë, breza dhe ngjarje aq të ndryshme sa që shpërbëjnë çfarëdolloj stereotipi race apo kulture. Punëtorë e sipërmarrës. Artistë e bujq. Studente dhe nëna me fëmijë. Ata që kanë ardhur me skaf, e të tjerë që kanë ardhur me avion. Kishte nga ata që mendonin se Italia ishte vendi i Mullirit të Bardhë (Mulino Bianco), e të tjerë, si Alberti dhe Dardana që mendonin se ishte "Vendi i De Chiricos".

MIMOZA DHE RRËNJË

Në malet e Trentos, ata të dy, që ende e ndiejnë veten njerëz bregdetarë, zunë rrënjë të reja: një shtëpi, një fëmijë, një kompani teatrore, me të cilën realizojnë projektet e tyre. Sot të dy janë shtetas italianë. "Kujtimi i parë i mbërritjes - tregon Dardana - është vitrina e një librarie në

Brindisi: atje përpara të gjithëve, ishin gjithë librat e ndaluar që ne ëndërronim të lexonim. Ndërsa isha duke i vrojtuar, një grua më zgjati një tufë mimozash për 8 mars. Vetëm kur u largua vura re se në letrën me të cilin e kishte mbështjellë, ishin fshehur të holla. Ja Italia, i thashë vetes: një e panjohur të dhuron lule dhe të holla për të cilat e di se ti ke nevojë", Për Italinë, këtyre 18 viteve, ata të dy nuk kanë ndërruar kurrë mendim. As në ditët me pagesa të parregullta e me dhimbje shpine lart e poshtë nëpër tavolinat e një restoran-

Corriere della sera, Repubblica, New York Times. Janë të shumta gazetat e mëdha italiane e të huaja që tashmë i kushtojnë dossier të tëra komunitetit shqiptar në Itali duke "zbuluar" se janë ndryshe nga ç'ishin paraqitur deri dje. Duke pranuar haptas se sot, miti i shqiptarit të keq ka vdekur. Ose në mos miti, ato elemente që mund ta ushqenin. Përfshirë shtypin që tashmë e deklaroi troç. Si në rastin e Corriere della Sera në një speciale të para disa muajve se "shqiptarët, prototipi i emigrantëve "të këqinj dhe të dhunshëm", nuk na trembin më. Janë integruar, punojnë, shumë janë bërë sipërmarrës të vegjël dhe pasi kanë bërë "fat", ka nga ata që kthehen në atdhe për të vënë në punë kapitalin ekonomik dhe profesional të fituar në Itali". Artikulli i fundit, i riprodhuar këtu në shqip është i D di Repubblica, në tetëmbëdhjetëvjetorin e eksodit, mars 2009.

DARDANA ALDI SAIMIR kundër stereotipave

Nuk kërkonin vendin e "Mulino Bianco-s", por trojet e De Chirico-s dhe të Calvino-s. Artistët dhe studentët e ardhur në Itali nga Shqipëria tregojnë si ka ndryshuar komuniteti i tyre



ti. Apo në netët e pagjuma duke pikturuar e duke mësuar italishten. "Ambientimi ishte shumë i vështirë, vinim nga një botë në të cilën kishim një identitet, një profesion, një rol social. E gjithë kjo, këtu nuk vlente asgjë". Kurse tani, vlen pasja e dokumenteve ku shkruhet "shtetas italian". Sepse " pas gjithë përpjekjes së bërë për tu integruar, kjo njohje do të thotë të kesh sërish një identitet të përkufizuar dhe të mund të marrësh pjesë në zgjedhjet e vendit ku jetojmë, ku paguajmë taksat, ku shkollojmë fëmijën tonë". Dhe vlen edhe puna e kompanisë, Quarta Parete (me të cilën në sezonin e kaluar vunë në skenë romanin e shkrimtares shqiptare Ornella Vorpsi, La mano che non mordì, dhe sapo janë rishfaqur me spektaklin e ri Ditë vere

Disa nga studentët shqiptarë të regjistruar në Universitetin e Torinos, qyteti italian me numrin më të madh të studentëve nga Shqipëria (plot 1.200). Nga e Majta: Ergys Kastrati, Dafina Ikonomi, Lirien Mihali, Saimir Baci, Elona Sako dhe Aldi Pupuleku

të Slawomir Mro ek), që lëviz pikërisht në kufirin e lehtë midis dëshirës për integrim dhe ruajtje të origjinës së vetë. "Im at" thotë Alberty, "më thoshte shpesh se kur hynë në një shtëpi të re, duhet të prezantohesh para se i zoti të të pyesë cili je: kjo është ajo që u përpoqëm të bënim ne kur erdhëm këtu. është e vërtetë se shumë shqiptarë erdhën pa arsim, pa formim profesional, pa mbështetje, dhe humbën. Por në vend që të flitej për raste të izoluara, iu vu faji një populli të tërë". Bashkësia shqiptare, është sot, thotë Alberty, një "bashkësi në reflektim", njerëzit e të cilës ka kuptuar që për të ndërtuar një histori të re, "duhet të mësojë si të përdorë lirinë". Por Italia ka ende nevojë për koka turqish.

vijon nga faqja 23

"Dhe tani "urgjenca shqiptare" ka dalë jashtë mode, armiqtë e rinj janë rumunët".

NJË BREZ TË HUAJSH

Ky është qyteti im. I ngadaltë e barok. Siç ndihem edhe unë". E ulur në një bar të Romës, Anilda Ibrahim, vrojton qarkullimin e plogët të së dielës pasdite. Në tavolinë përpara saj një gazetë e hapur buçet në faqe të parë alarmin e fundit për imigrantët. "Frika e njerëzve janë një serbator i mirë konsensusi mbi të cilët të ushtrohet presion", thotë Anilda, ndërsa cigarja e disatë konsumohet në ajër. "Në 1994 dhe në 1998, gjatë zgjedhjeve ishim ne shqiptarët ata që mishëruan kërcënimin e të huajit të keq. Tani e kanë radhën rumunët. Por dyshimi nuk lehtëson bashkëjetesën. E pashë se si ndodhi edhe me komunitetin tim, që për shumë kohë vuajti për të krijuar një rrjet, një organizim të brendshëm: paragjykimet na ndanë, ngadalësuan integrimin". Asaj që ka lindur në Vlorë, dhe që me zanat është shkrimtare, për paragjykimet asnjëherë nuk i është dridhur qerpiku. Shumë e gjatë dhe ndërlikuar historia e saj - më parë korrespondente në Zvicër, për një gazetë shqiptare, e pastaj gazetare në Vlorë gjatë trazirave të '97, pastaj përgjegjëse shtypi për Komitetin e Refugjatëve në Itali, dhe së fundi shkrimtare e botuar nga Einaudi, me një roman të suksesshëm "Rosso come una sposa" - tepër kozmopolit formimi i saj, tepër të përziera rrënjët e saj dhe është e vështirë ta përkufizosh emigrante. Por është shqiptare edhe ajo. "Krenare për këtë madje". Edhe pse ngandonjëherë "kur dikush më pyet se nga jam, e ndiej të nevojshme ta qetësoj. Ndoshta për shkak të asaj vetëtime habie që vërej në sytë e njerëzve kur u them se nga jam". Në Romë e çoi fati, thotë, apo nevoja për njohje. Kur ishte fëmijë, në leksik familjar, Italia ishte vendi i alegrisë kaotike dhe të shfrenuar. Vendi i rëmujshtëm dhe i zhurmshëm buçiste në fjalë e të atit kur ajo dhe i vëllai bënin shumë zhurmë: "Pushoni, nuk

DARDANA ALDI SAIMIR kundër stereotipave

Nuk kërkonin vendin e "Mulino Bianco-s", por trojet e De Chirico-s dhe të Calvino-s. Artistët dhe studentët e ardhur në Itali nga Shqipëria tregojnë si ka ndryshuar komuniteti i tyre

jemi në Itali këtu!". Kur ishte e vogël kur mbaronte orën e vizatimit teknik vraponte në shtëpi për të ndezur radion, Italia ishte vendi i Hit Parejdit. Atje ku një ditë do të shkante për të dëgjuar *live* Tullio de Piscopo-n. Kur pastaj, u rrit dhe për herë të parë lexoi *Se una notte d'inverno un viaggiatore*, Italia u bë vendi i Italo Calvino-s. Vendi i gjuhës së lehtë dhe të thatë - kaq e ndryshme, për përmbajtje dhe shije nga "emfaza e shqipes" - që e zgjodhi për të shkruar romanin e saj të parë. Tani për të dytin që do të dali nga Einaudi në tetor, Anilda ka vendosur të kthehet në Ballkan. Por për të treguar historinë e personazheve që e gjejnë diku tjetër fatin e tyre. Pikërisht siç i ndodhi asaj. Siç i ndodhi edhe Olen Cesarit, i cili në Romë zbarkoi në moshën 13-vjeçare për të studiuar violinë, falë një burse studimi shqiptare: "Në fillim qe shumë e vështirë, paratë nuk mjaftonin kurrë. Për të mbijetuar i bija violinës për turistët në Piazza Navona". Pastaj ia behu diploma në konservatorin e Santa Cecilia-s, koncertet, disqet. "E kaloj



Albert Dedja (skenograf dhe piktor) dhe Dardana Bërdyna (aktore) kanë ngritur në Trento "La Quarta Parete", një trupë me të cilën realizojnë projektet e tyre teatrale. të diplomuar në Akademinë e Tiranës, para se të emigronin punonin në teatrin e Durrësit.



Dardana gjatë provave të trupës së saj teatrale. pasi sollën në skenë, vitin e shkuar, përshtatjen e romanit të Ornella Vorpsit, La mano che non mordi, sot La Quarta Parete është në turnée me *Giorno d'estate* të Slawomir Mrozek.

jetën në *tournee*, ndihem një cigan, ëndrra ime është udhëtimi shtatë herë rreth globit. Po të kisha një fëmijë nuk do të doja kurrë që të ishte vetëm italian. Unë - me baba italian, nënë shqiptare, një gjyshe greke, dhe një tjetër bullgare - jam lindur midis katër fesh. Flas shtatë gjuhë, dhe me shqipen nganjëherë bëhem lëmsh...". Kurse Anilda flet shqip me të bijtë - "është vendi ynë i fshehtë, me fjalët e lashta të dashurisë dhe të përkëdheljeve" - dhe në verë, kur kthehet në Vlorë. "Por sot nuk është e lehtë as në Shqipëri. Brezi im ka ikur i gjithi, dhe kanë sjellë në jetë një brez të huajsh. Kur takohe mi në Shqipëri me të afërmit e mi, fëmijët tanë e kanë të vështirë të komunikojnë. Kanë origjinë shqiptare, por para së gjithash janë francezë, italianë, amerikanë".

DRITARJA MBI TIRANË

Edhe djemtë e Torinos, janë "të huaj". Çanta të mbushura me libra, dhe vështirmë plot me pyetje, kanë ardhur këtu për të marrë një diplomë dhe për të krijuar një të ardhme. Fytyra të ndryshme, dhe mënyra të ndryshme për të dalë nga hija, Lirien, Edit, Ilir, Aurora - kanë të përbashkët çrrënjosjen e migruesve - shqiptarë në Itali e italianë në Shqipëri - dhe një jehonë të së kaluarës. Si shija e petëve të byrekut të gjyshes. Apo kujtimi se si të djeg fytyrën një teke raki e kthyer me fund. Në Torino qyteti italian, me numrin më të madh të studentëve universitarë shqiptarë (1200), kanë themeluar, në 2005, shoqatën Mërgimtari (www.mërgimtari.info) me seli edhe në Cuneo: (www.associazionemërgimtari.com) e lindur shpjegon Iliri "për të mos u ndier të vetmuar, të humbur, pa qenë në gjendje të shprehim indinjatën e të qenit të diskriminuar". Brezi i fundit i shqiptarëve që kanë kapërcyer Adriatiku, ka sipas tij, një mundësi të madhe, të tregojë se cilët jemi një vendi që nuk na njeh. *Albania 1 e 1000*, revista e tyre e menduar dhe e shkruar në të dyja gjuhët ka lindur për këtë arsye. Për të treguar historitë e tyre. Për të dalë hapur duke mposhtur tundimin e të fshehurit. "Këtu në Itali - thotë Au-

CALL YOUR COUNTRY
PER ILI ALONZI
WIND

Bota shqiptare

GAZETA E SHQIPTARËVE NË ITALI

CALL YOUR COUNTRY
PER ILI ALONZI
WIND

il mondo albanese
E GAZETA DESA ALBANESI IN ITALIA
Quotidiana - Anno 31, n. 210
16 - 31 marzo 2009 € 2,00

Iscrizione Registro Stampa del Tribunale di Roma n. 213/99 del 12.05.99. Iscrizione ROC n. 13252. Direttore Responsabile Elio Ricchiuto.
Editore: Bota Shqiptare s.r.l., Viale Marco Polo 119, 00154 Roma. Stampa: Eurostampa s.r.l., Roma. Distribuzione Nazionale Editrice: Innoventor s.r.l., Milano. Sped. in abb. post. n. 3061/A/01 del 30.03.2002. B. 46/2004/01. P. 11. - CN/SC. Roma

ISSN 1120-9478 0 0 2 1 0
9 77112094781101

**Anija ime
quhej "Legend"**

Roland SEKO

Nuk është nevojë të gërmosh kujtesën për të rindëruar ato ditë fillimi masiv të vitit 1991. Kudo që i ka jetuar, si protagonist a si spektator, nuk mund t'i harroje, pasi ato kujtime, në mos përfshin shkandur nga goditje në të vënda, përbejnë për shumicën tonë momentin e tranzitit, kthesën rritëse që ka përcaktuar përfundimisht jetën që bëjmë sot.

Fati i përbashkët i atyre ditëve lëbri po ng të përbashkëta edhe kujtimet të cilat, edhe pse personale, shndërrohen në një unifikim të të gjithëve ka tuzoben dallig, anije, frikë, shpresë, zhgënjim, hare, një vortball imazhesh e ndryshqish që vetem caset e rëndësishme janë në gjendje të ngjallin.

Anija ime quhej "Legend". Pakfish e njëh me këtë emër, pasi në kronikat e arratisë së atyre ditëve ka hyrë me emrin "anija panameze". Omen, nomen. Për nuk mund ta dja që në cast se fati im dhe i pesëmijë bashkëditëtarëve ishte shkruar në barkun e ndryshkur të asaj anijeje të ngarkuar me çimento në portin e Durresit 6 marsit e vitit 1991, pa parur kurrë të kaproja edhe vetë si dhe pse gjendsha ary. Një sirenë, a çirçe më pat bërë të kërkoja me ngulim një makinë e të nissha nga Elbasani për në Durres. Iani e di që pa një çantje të pushkësime që diku dergej të unë e te mijëra të jetë, nuk do të isha nisur, ashtu sic nuk do të isha nisur edhe kolegu im E.M. në kombinatin metalurgjik i cili, tek dera e ndërrime, bëshoi eshtu më kot tha "po vij edhe unë në Durres-por me kush-që-të-ktheshmë brenda orës-me".

As ai, as unë, nuk e dimni ku po shkoni. As ai, as unë, nuk e kuptuan si u gjetën në barkun e "Legendës" me flamur panamaz ku këmbët na i çoi turna nga shkoceti dhe mendjen na e pat marrë sirenja e detit.

vijon në faqen 2



UDHEZIME për kapërcimin e detit

- MBËRRITJET - UDHEZIME PËR KAPËRCIMIN E DETIT
- ÇORODITJA - FIDANISHTET E DHUNËS
- PËRBALLIMI - DYNDJA E PAPANUAR
- PARAGJYKIMI - KRIJIMI I ARMIKUT
- KONSOLIDIMI - LEJQËNDRIMI, PUNË, SHTËPI
- IDENTITETI - DYZIMI MES DY BRIGJEVE
- NGULIMI - KAPËRCIMI I PLOTË I DETIT

**1991
mars
2009**

Mes mbërritjesh
biblike,
mikpritjeje
e dëbimi,
paragjykimesh
e vështirësish
jete, portreti
tetëmbëdhjetë-
vjeçar
i shqiptarëve
në Itali

*dossier special
kushituar
tetëmbëdhjetë viteve
të emigracionit
shqiptar në Itali*

Numri 210 i Botës Shqiptare, që gjeni në treg, i kushtohet tetëmbëdhjetë viteve të emigracionit shqiptar në Itali



Elona, Ergysi, Dafina, Lirien dhe Aurora Kociki. Bashkë me studentë të tjerë, në vitin 2008, kanë hapur revistën Albania 1 e 1000. E shkruar në Italisht dhe shqip, revista do të shpërndahet, nga prilli, në pikat e shitjeve të cigareve dhe në librari.

rora . U përballa për herë të parë me mosbesimin; më shikonin me dyshim, më perceptonin si një rrezik potencial. Mimetizimi, në fillim ishte një mënyrë për të mbijetuar". Edhe Editit, që erdhi në Torino, për të studiuar Shkenca Politike, iu deshën vite para se fliste lirisht shqip përpara të tjerëve. "Fillova kur këtu erdhi edhe motra ime, dhe më tha se dueht të isha krenare për prejardhjen time: vetëm duke kujtuar se nga vjen mund të integrohesh". "Ata që vijjnë sot këtu janë studentët më të mirë të shkollave tona" sqaron. Por pasi kanë luftuar për katër vjet me burokracinë e lejeqëndrimeve, në fund të universitetit lodhen dyfish për t'iu ngjitur të njëjtës malore si edhe italianët: "kur je shqiptar është shumë më e vështirë të tregosh sa vlen". Për dikë kthimi është një nga mundësitë. Shqipëria fillon të rritet me 6% në vit, dhe është tashmë në pragun e BE-së, dhe qeveria e saj (në prag zgjedhjes) fillon të nuhasë se nga do të shkojë e ardhmja, dhe thërret në atdhe trurin e larguar, duke lehtësuar hyrjen e studentëve që kanë marrë një titull jashtë shtetit. "Flitet gjithmonë për Shqipërinë e djeshme e kurrë për atë të sotmen" thotë Leonardi, i sapo diplomuar në Akademinë e Arteve të bukura. "është një vend në rritje, dhe shumë mirë madje. Shumë prej atyre që ishin larguar po kthehen, dhe po investojnë paratë e tyre atje. Ende mbetet shumë për të bërë, por mjafton të shihet Tirana për të kuptuar, është një qytet i ri, frenetik, plot me studentë, me baret gjithmonë të hapura". Instalacioni i tij i fundit, i ekspozuar në Torino gjatë ekspozitës ContainerArt, hap një dritare pikërisht mbi Tiranën: nga një ekran i ndriçuar mbërrijnë imazhet e mara drejtpërdrejtë na kryeqyteti shqiptar. "Kështu e ka arti" thotë " vrojton jetën dhe e filtron atë, duke vënë në komunikim botë të ndryshme. Duke krijuar, tregoj historinë time me simbole. Patjetër, ndiej marrëdhënien me prejardhjen time, por tani më shumë se e kaluara më intereson e ardhmja".

Irene Alison,
D di Repubblica, marzo 2009



DITAR PUSHTIMI

6 prill 1939, e enjte

Në orën 4 kolona e Komandës së Regjimentit mbërrin në Brindisi. Sipas urdhrin të marre, trupa çohet në kazermën e 47-të të Këmbësorisë, ndërsa materialet dhe mjetet e lëvizshme dërgohen në molon pranë anijes "Adriatico" për t'u imbarkuar.

Të njëjtin urdhër kanë marrë Batalionet II dhe XVII, repartet e të cilave janë vendosur në shkollën fillore për djem. Batalioni II do të ngarkohet në anijen "Toscana" dhe kompania e 9-të mbi anijen mbretërore "Miraglia".

Në orën 13 është imbarkimi i fundit i materialeve, fillon shpejt ai i njerëzve.

Në orën 16 të gjithë janë në bord...

Ndërkaq marr prej Komandës së trup-ekspeditës urdhrin e nisjes, pra urdhrin e shërbimeve nr. 1 dhe fletën nr. 28 të protokollit lidhur me shërbimin postar për OMT (Oltre mare Tirana - kështu ishte emërtuar operacioni italian në Shqipëri)

I thirrur prej gjeneralit Messe, marr urdhrin e tij të operacionit nr. 1. Sipas tij, në të është përcaktuar, që zbarkimi në Durrës do të bëhet në orën 4 nën mbrojtjen e anijeve të luftës dhe të një kompanie të Marinës Mbretërore.

(...) Në orën 16.30 ngjitemi në anije. Pak më pas anija "Adriatico" lë portin dhe del në det të hapur, ku bashkohet me kolonat e tjera, edhe ato të nisura nga Brindisi.

Lundrimi bëhet në mënyrë të rregullt. Koha e bukur.

7 PRILL 1939, E PREMTE

Nga Ditari historiko-ushtarak i Komandantit të Regjimentit II Bersaglieri në ditët e pushtimit të Shqipërisë nga Italia



04/1939

operazione OMT - oltremare tirana

Zbarkimi filloi në orën 5.25 të 7 prillit. Në orën 10.10 të 9 prillit Tirana ishte e pushtuar. Mbreti Zog dhe familja kishin mbërritur ndërkaq në Greqi. Operacioni ushtarak i pushtimit u kushtoi italianëve vetëm 12 të vranë dhe 81 të plagosur.

Në 12 prill një asamble kushtetuese shpalli rënien e mbretit Zog dhe formimin e një qeverie kolaboracioniste. Më 16 prill Viktor Emanueli III pranonte zyrtarisht kurorën e Shqipërisë. Mbretëria "e bashkuar" e Italisë dhe Shqipërisë do të merrte fund me kapitullimin e Italisë në shtator 1943.

7 prill 1939, e premte

Në orën 4 jemi në shikim të Durrësit, para daljes së dritës dhe pak pas errësirës së natës. Filloi zbarkimi prej kolonave të para. Piroskafi, mbi të cilin ndodhem, ndalet në det të hapur. Zbarkimi në Durrës ka shkaktuar reagim të përmjehershëm kundërshtues. I pandërprere është zjarri i pushkatarëve dhe i mitralozave prej anijeve mbretërore.

Nga toka, kundërshtari hyn në veprim me artileri. Rreth orës 6 i afrohet piroskafit tonë rimorkiatori Adige i Marinës Mbretërore, që urdhëron të imbarkohemi në të dhe të na çojë në Durrës. Fillon menjëherë imbarkimi i motoçikletave dhe i njerëzve: secili në vendin e vet, komanda e regjimentit, kompania mitraljere me biçikleta, pjesa e mjeteve dhe komanda e Batalionit XVII me kompaninë e motoçiklistëve.

Në orën 7 rimorkiatori preken dhe menjëherë ka filluar zbarkimi, nën zjarrin e pushkëve kundërshtare. Ndërkaq nis, nga një pjesë e Batalionit X, zgjerimi i kreut të zbarkimit, ribashkon trupat e zbarkuara në molo dhe mbetem në pritje të urdhrave. Ndërkohe fillon zbarkimi i Regjimentit të 2-të dhe të kompanisë së blinduar. Në orën 11.45 marr urdhër nga Komanda e kolonës Messe për të zëvendësuar me dy batalione grupin Anderson në pushtimin e kodrës, kaluar kuotën 30, qëndroj deri në orën 16. Pas kësaj ore do të na çojnë

vijon në faqen 28



Një shtëpi në Tiranë, kushton më pak se një garazh në Romë! Dhe vlera i rritet çdo ditë!



Planimetria e një apartamenti tip dhe lart pamje e simuluar e pallatit. Apartamentet në shitje janë në ndërtim e sipër.

Apartamente banimi në gjelbërimin e parkut të Liqenit, pranë kopshtit botanik të Tiranës.

**Sipërfaqe të ndryshme
Duke filluar nga 800 Euro m2**

K & M Constructions

Tiranë - 069-2080820

Romë - 334-2926786

Ditar pushtimi vijon nga faqja 26

për të pushtuar pozicionet e Shijakut duke bllokuar ardhjet nga Tirana; pushtimi duhet shtrirë në Jug deri në Borak. Pushtimi në fjalë nga ora 18.

Filloi menjëherë lëvizja me repartet tashmë të zbarkuara (Komanda e Regjimentit, komanda e Batalionit XVII, dy toga të kompanisë së 8-të motoçikliste, kompania e blinduar, një kompani çiklistësh, dy skuadra mitraljere të kompanisë së 4-t).

Mbërritja e kuotës 30 parashikon zëvendësimin e grupit Anderson. I dërgoj komandës së kolonës vendosjen e reparteve (lidhja 9). Ndërkohë kanë ardhur repartet e mbetura të regjimentit. Në orën 15.45 dëgjohej një shpërthim i fuqishëm dhe shihet tym në Shijak, është hedhur në erë ura e ndodhur në brendësi të tij. Për këtë i jap njoftim menjëherë komandës së kolonës e ndërkohë vendos për të shkuar përpara patjetër nga kuota 30, në mënyrë që të mos i jepet kohë armikut që të hedhë në erë edhe urën e EIA-s, nëpërmjet së cilës mund të arrijmë njëloj objektivat e shënuara për ditën.

Urdhëroj pastaj komandantin e Batalionit XVII të arrijë shpejt urën që thamë, të kryesojë një togë deri kur të jetë zëvendësuar toga mitraljere e me trupa të tjera të mjaftueshme të Shijakut, me zënë lartësitë e Guses, me bllokuar rrugën e Tiranës dhe me nxitur një togë motoçiklistësh të pushtojnë shtigjet e Guses.

Me batalionin e çiklistëve (më pak se një e treta) urdhëroj të ndjekë lëvizjen batalioni XVII, dërgoj një kompani ne Borak, për të ndërmarrë lidhje nga e djathta me batalionin e motoçiklistëve e me kompaninë, pushtoj menjëherë pozicionet në të djathtë të batalionit të çiklistëve në lindje të Shijakut.

Lëvizja ka nisur menjëherë: në orën 15, një pjesë e batalionit të motoçiklistëve, i ndjekur shpejt prej batalionit, pa kompaninë e 3-të dhe dy skuadra mitraljere të kompanisë së 4-t, që po ktheheshin nga pozicionet e pushtuara në kuotën 30 do të mbeten në dispozicionin tim.

Megjithatë, pas mbërritjes së gjeneral Guzzoni-t e informoj për situatën dhe veprimet në zhvillim.

Pastaj shkoj tek ura e Shijakut për t'u njohur me dëmet. Ndërsa ndjek rikonicionin, shoh çiklistët në mjete për Tiranë. Për çështjen e rikonicionit informoj komandën e kolonës (lidhja 10).



ULTIMATUMI

Më 8 janar 1939 kryetari i qeverisë fashiste, Benito Musolini, miratoi planin e Cianos për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Ahmet Zogu mori disa masa kundër planeve italiane. Ambasadori italian në Tiranë protestoi për keto masa. Ndërkohë, në Italinë e Jugut u përqendruan forcat ushtarake që do të realizonin pushtimin. Më 25 mars 1939 Ahmet Zogut iu paraqit një projekt-traktat nga qeveria italiane që synonte nënshkrimin e Shqipërisë. Por Ahmet Zogu e la në heshtje. Pasi iu përsërit më 2 prill, iu paraqit ultimatumit me afat deri në orën 12 të datës 6 prill. Më 5 prill 1939 Qeveria Shqiptare i paraqiti ministrit italian në Tiranë kundërpropozimet, në të cilat kërkohej të përfundohej një konventë ushtarake dhe të përcaktohej rrethanat kur ushtria italiane mund të vendosej në Shqipëri. Më 6 prill pasdreke, parlamenti shqiptar e hodhi poshtë ultimatumin e B. Musolinit. Në mëngjesin e 7 prillit 1939, trupat fashiste italiane, prej 30 mijë vetësh e sulmuan Shqipërinë dhe zbarkuan në Durres, në Vlorë, në Shëngjin dhe në Sarandë.



Në orën 18.19 hyj në lidhje me komandantin e batalionit çiklist, që ka mbërritur pozicionet e shënuara, pas një qëndrimi në luftim të menjëhershëm në lindje të Shijakut, në rrugën e përshtatshme për Tiranë. Në këtë aksion janë kapur: 38 të burgosur, 10 mitraloza, një duzinë arkash me municion e material të ndryshëm. Asnjë i vdekur nga ana e kundërshtarit, asnjë humbje nga ana jonë.

Në orën 19 edhe batalioni çiklist, që kishte zëvendësuar me një togë çiklistësh elementet e batalionit motoçiklist, të lënë në roje të urës së EIA-s, mbërriti në pozicionet e veta.

Ndërkohë mbërriti bateria 20 e Divizionit "Murge" që më është dërguar për zëvendësimin e baterisë 65/17.

Vendos të qëndroj me komandën e Regjimentit e me repartet në dispozicionin tim, që ndërkohë më kishin mbërritur, në udhëkryqin në lindje të Shijakut.

Prej kompanisë, në dispozicionin tim, dërgoj një skuadër tek ura e Shijakut dhe një togë tek ura e EIA-s, e cila zëvendëson togën tjetër çikliste të kompanisë së 2-të, që mbërrin patjetër repartin.

Pasi i komunikoj një dislokim të tillë komandës së kolonës, ndërkohë i kërkoj të më dërgojnë ushqime e karburant.

Në orën 24 marr urdhrin e operacionit nr. 2, në lidhje me ndërmarrjen e përparimit mbi Tiranë (lidhja 11)

Për të tilla veprime më vjen komanda nga skalioni i parë i kolonës, i përbërë prej batalioneve të regjimentit tim (II çiklist dhe i XVII motoçiklist dhe batalioni XXVII çiklist i Regjimentit 11 Bersalier (pa një kompani) që në orën 6.30 do të mbërrin në vendin e tanishëm të qëndrimit dhe prej baterisë prej 20 grykësh.

Detyra ime:
 - me lëshuar për zbulim elementet motoçiklistë dhe karrot.
 - të pushtoj luginën e Vorës dhe të garantoj zotërimin e saj me batalionin XXVII.

- të përparoj mbi Tiranë, duke pushtuar pozicionet e Mëzezit dhe Yzberishtit dhe duke siguruar zotërimin e fushës së aviacionit, me të cilën duhet të lidhem menjëherë, për kushtet e uljes së avionëve.

Duhet lëvizur prej Shijaku, në mënyrë që të mos arrihet gryka e Vorës para orës 8, sepse prej orës 7 deri 8 aviacioni do të kryejë veprime bombardimi mbi zonën e të njëjtës grykë.

Koha e bukur.

Kolonel, Komandanti i Regjimentit Nino Sozzani



Identiteti dhe kulturat e një kryeqyteti multi etnik

Tregoni historinë tuaj




Dërgo fotografi, video dhe mesazhe zanore tek

www.migrart.it



contrasto






HORIZONTALISHT

1. Paraardhësit tanë edhe para ilirëve. 9. Reduktim; shterim. 14. Bashkëpunëtorët në një kauzë. 15. Shkronjë e alfabetit grek. 17. Holloj hekurin. 18. Merr fund; përfundon. 19. Fillon. 21. Motër e nënës. 22. Pak gallashtë. 23. Tip arme e vjetër. 25. "Fustani" i indianeve. 26. Anatoly, shahist rus, kampion bote. 29. Një e tillë i drejtohet Zotit. 30. Stativi pa savi. 31. Mbretërit e Egjiptit të lashtë. 33. Era pa fund. 34. Rrëshket në dëborë. 36. Njëra pjesë e këstit. 38. Gjysëm Kine. 39. Rrymë filozofike. 42. Deliri pa çifte. 43. Stabilizator pa abiliator. 44. Përgatitje e ushqimit. 45. Mace mashkull. 46. Vila pa krye. 47. Kur je shumë frikacak, populli thotë që ke frikë dhe nga ai. 48. Flori. 49. Brinjët e një trekëndëshi. 51. Kryeqyteti i Perusë. 52. Fuqi, forcë. 53. Vizatimet në trup.

VERTIKALISHT

1. Rrua e Molnarit. 2. Pjesët më të privileguara të klasave. 3. Trembet shumë; tmerrohet. 4. Shteti me Vietnane. 5. Ndajfolje vendi. 6. Kap; arrij. 7. Gati pa çifte. 8. Teatri Operas e Baletit. 9. Parafjalë e gjuhës shqipe. 10. Zbardh dita. 11. Mund të jetë vaditës. 12. Organ më i lartë i pushtetit shtetëror në Romën e lashtë. 13. Si janë disa CD, të.... 16. Libër i J. Massenet. 18. Venier e RAI-t. 20. Futje në lëkurë me shiringë e ilaçit. 22. "Shtëpitë" e makinave. 24. Spellë. 25. Inkuizicioni dogji edhe ato në turrën e druve. 26. Pjesa e një ndërtese. 27. Ruajnë rendin. 28. Kompozoi Aidën. 31. Mbushin kinematë. 32. Dallgë e fortë. 35. Qeni që "fluturoi" në kozmos. 37. Sipas popullit, herë herë kur ekzagjeron e bën qimen. 40. Gavril i Riu, poeti arbëresh. 41. Hari, spiunia. 43. Will, aktor amerikan. 50. Përemër i gjuhës italiane. 51. Pleh pa limite.

VERTIKALISHT: 1. PAL. 2. ELITAT. 3. LEMERISHT. 4. LAOSI. 5. ATJE. 6. ZE. 7. GT. 8. TOB. 9. PER. 10. AGON. 11. KANAL. 12. SENAT. 13. MASTERIZUAR. 16. MANON. 18. MARA. 20. INJEKTIM. 22. GARAZHET. LUTJE. 30. TTL. 31. FARAONET. 33. ER. 34. GA. 23. NAGANT. 25. SARL. 26. KARPOV. 29. LIMOI. 18. MBARON. 19. NIS. 21. TEZE. 22. PAKESIM. 14. ALENTET. 15. OMEGA. 17. HORIZONTALISHT: 1. PELLAZGET. 9. TAKAT. 53. TATVAZHET.



HORIZONTALISHT

1. Skemë e diçkaje që do të ndërtohet. 8. Banorë të një qytet-shteti në Greqinë e lashtë. 15. Quajnë shqiptarët në trojet e tyre në Greqi. 18. I pandershëm; pa parime. 19. Shteti afrikan me kryeqytet Kigali. 20. Kadri, aktor shqiptar. 22. Organ Kryesor. 24. Ladi shumë i ngatërruar. 25. Qëndrim as pro, as kundër në votime. 27. Revan pa ren. 28. I hidhet sipër kadaifit. 31. Mbyllin misteret. 32. Ojnat; përkëdhelitë. 34. Përemër i gjuhës italiane. 35. Tesera pa çifte. 37. Njerëz që heqin dorë vullnetarisht nga gëzimët e jetës. 38. Vend fushor pa drurë e klimë të thatë. 41. Realizohet, kryhet. 43. Togë Sulmuese. 44. Fundi për një vatër. 45. Verë pa zanore. 46. I përdorur në ambalazhim. 47. Kalë në dialekt. 48. Gradë oficeri madhor. 49. Është Hëna për Tokën. 53. Nye e anglishtes. 54. Shenjë në matematikë. 56. "Shtëpi" për bagëtinë. 57. Gjysmë mode. 58. Personazh femëror tek "Shkëlqimi e mjerimi i kurtizaneve". 59. pa shkwlqim. 60. Pikërisht ashtu..

VERTIKALISHT

1. Kryeqytet Europian. 2. Shenja të pleqërisë. 3. Vezake, eliptike. 4. Një muaj i ftohtë. 5. Thurr. 6. Markë makine koreane. 7. Tip pistolette. 9. Veprimi që bëhet kur kihet etje. 10. E themi në fund të lutjes. 11. Gjysmë rozë. 12. Tremb për vdekje. 13. Aleanca Anti Kosovare. 14. Në targat e Hollandës. 16. Gjyqtar në lojë. 17. Sinjal i ndihmës. 21. Teknikisht dëgjimi më i pastër. 23. Vend ku ndizen drutë. 25. Mat pa kokë. 26. Qendër studimesh shkencore. 27. Rrufeja. 29. Rrëzohem. 30. Ent Organizativ. 33. Foni. 36. Janë plus asaj që vendoset. 38. I përpiktë; pa gabime. 39. Fëmijë. 40. Pasuri. 41. Mbrëmje vallëzimi. 42. Një kanal televiziv shqiptar. 46. Si ai i Rodonit. 47. Paçino, aktor. 50. Agjenci Ajrore. 51. Fryn velat. 52. Selleck, aktor. 55. Ushtria Popullore.

VERTIKALISHT: 1. PARIS. 2. RRUDHAT. 3. AL. 50. AA. 51. ERA. 52. TOM. 55. UP. PRONE. 41. BALLO. 42. TNSH. 46. KEP. 47. SHTESA. 38. SAKTE. 39. EVLAT. 40. 27. VETITIMA. 29. BIE. 30. EO. 33. ZE. 36. STEREO. 23. VATER. 25. AT. 26. INSTUT. 13. AAK. 14. NL. 16. ARBITER. 17. SOS. 21. PIVET. 10. AMIN. 11. RO. 12. TROMAKS. OVALE. 4. JANAR. 5. END. 6. KIA. 7. TT. 9. VERTIKALISHT: 1. PARIS. 2. RRUDHAT. 3. MO. 58. ESTER. 59. OPAK. 60. TAMAM. SATELIT. 53. AN. 54. PLUS. 56. HAVUR. 57. 46. KARTON. 47. AT. 48. KOLONEL. 49. STEPPE. 41. BEHET. 43. TS. 44. ER. 45. VR. 32. NAZET. 34. IO. 35. TSR. 37. ASKETE. 38. ARBENIM. 27. VA. 28. SHERBETI. 31. ET. RVANDA. 20. ROSHI. 22. OK. 24. IDLA. 25. TANE. 15. ARVANITAS. 18. IMORAL. 19.

www.stranieriinitalia.it

Faqet internet të emigracionit

Çdo ditë lajme, hulumtime dhe informacione të dobishme për të gjithë të huajt në Itali.

Stranieri in Italia



Dashi (21 mars - 20 prill)

Dashuria: Ky muaj do të jetë disi i mërzitshëm, do të jeni të prirur të izoloheni, gjë që do të inatosë partnerin. Puna: Do të mbronni me mish e me shpirt punën e një kolegu edhe pse kjo do t'ju kushtojë antipatinë e një superiorit. Shëndeti: Mundohuni të mos e teproni me të ngrënë, veçanërisht të ëmbëlsirave.



Demi (21 prill - 20 maj)

Dashuria: Do të keni kurajë për t'u shprehur qartë më një të njohur të re, apo për të prishur një marrëdhënie tashmë në krizë. Puna: Mendimet tuaja do të merren parasysh, gjë që do t'ju lejojë të jepni maksimumin në profesion. Shëndeti: Hiqni nga dieta juaj të skuqurat dhe ëmbëlsirat.



Binjakët (21 maj - 21 qershor)

Dashuria: Do t'ju duhet t'u përgjigjeni një më një dëshirave të partnerit për të shmangur diskutime të kota. Puna: Të rejtat që pritin ende nuk arrijnë e kjo do t'ju shkaktojë pakënaqësi dhe nervozizëm. Shëndeti: Për rigjenerimin e trupit dhe të mendjes bëni mirë të shkoni ndonjë ditë në një qendër bukurie.



Gaforja (22 qershor - 22 korrik)

Dashuria: Parashikohen mbrëmje plot emocione të reja; do t'ia kaloni më së miri, qoftë me partnerin, qoftë me të njohur të rinj. Puna: Nuk duhet t'u tregoni të tjerëve për projektet e reja, më mirë filloni t'i vini ato në jetë, veprat flasin vetë. Shëndeti: Kujdesuni më shumë për këmbët.



Luani (23 korrik - 23 gusht)

Dashuria: Do të keni dëshirë të kaloni më shumë kohë në shtëpi, në intimitet të plotë me njeriun e zemrës. Puna: Ambiciet e shumta mund t'ju hapin telashe të paparashikuara, mundohuni të qëndroni me këmbët në tokë. Shëndeti: Bëni rregullisht ndonjë shëtitje qetësuese më këmbë apo me biçikletë.



Virgjëresha (24 gusht - 22 shtator)

Dashuria: Do të ktheni ftesa të shumta vetëm e vetëm që të jeni në shoqërinë e të dashurit, pa praninë e të tjerëve. Puna: Do të jeni i palodhur dhe do të përmirësoni goxha imazhin tuaj profesional. Mos harxhoni kot energjitë tuaja. Shëndeti: Kushtojini më shumë rëndësi ngjënies mirë dhe me orar.



Peshorja (23 shtator - 22 tetor)

Dashuria: Do të arrini një harmoni të shkëlqyer me partnerin. Pas një aventure të vogël, do të vlerësoni më shumë marrëdhënien tuaj. Puna: Mundohuni të mos harxhoni burimet tuaja financiare me shpenzime të tepërta. Shëndeti: Vera po afron, ndaj merrni pak me trupin dhe hani ushqime të lehta.



Akrepi (23 tetor - 22 nëntor)

Dashuria: Do të mundni pasigurinë tuaj dhe do t'i paraqiteni dikujt që ju pëlqen pa masë. Puna: Do t'ia dilni mbanë me sukses në një situatë tepër të vështirë të sferës profesionale. Shëndeti: Mundohuni të mos pini për ca kohë pije alkoolike, kështu do ta keni edhe më të lehtë të dobësoheni.



Shigjetari (23 nëntor - 21 dhjetor)

Dashuria: Nuk do të nguroni para asgjëje sepse do të jeni të bindur se do të merrni vendimin më të përshtatshëm. Puna: Do të përjetoni një periudhë tonifikuese dhe plot të papritura, kështu që do të përmbushni të gjithë objektivat që i keni vënë vetes. Shëndeti: Përkushtojuni një sporti që luhet në grup.



Bricjapi (22 dhjetor - 20 janar)

Dashuria: nuk do të duroni kritikën dhe do t'i thoni në sy atë që mendoni partnerit... mundohuni, të paktën, të mos e teproni. Puna: duhet të jeni më dinamikë dhe të jepni maksimumin në punë, dikush ju ruan nga larg. Shëndeti: Do të ndjeheni në formë të shkëlqyer psikofizike.



Ujori (21 janar - 19 shkurt)

Dashuria: Do të jeni tërheqës, të hedhur, fjalëshumë dhe të aftë për t'i fituar zemrën kujt të doni. Puna: Duhet të bëni kujdes për të qenë sa më të përpiktë, përndryshe rrezikoni t'i tërhiqni punët zvarrë dhe të mos mbaroni brenda afatit. Shëndeti: Mundohuni të hani më shumë fruta e perime të pagatuara.



Peshqit (20 shkurt - 20 mars)

Dashuria: Mund të përjetoni një periudhë kalimtare të vështirë në dashuri për shkak të keqkuptimeve të njëpasnjëshme. Puna: Do të jeni të prirur të mos respektoni rregullat e të kaloni gjithë muajin duke ndjekur nisma të reja. Shëndeti: Duhet të regjistroheni sa më shpejt në një palestër apo të nisni të vraponi.

CATWALK

IL NEGOZIO DI ALTA MODA A TIRANA

Ermenegildo Zegna

CESARE PACIOTTI

GIANFRANCO FERRE

CERRUTI 1881



ONI PUSTINA

RRUGA MYSLYM SHYRI, TIRANA

a mund të dërgoj para
në **shqipëri** me

7€* komision?



transferta nga 100€ për në shqipëri duke filluar nga 7€**

tani edhe nga **toskana**

shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00
€100,01 - €200	€10,00
€200,01 - €300	€13,50
€300,01 - €400	€17,00

shuma	komision*
€400,01 - €600	€26,00
€600,01 - €800	€34,00
€800,01 - €1.000	€44,50

oferta është e vlefshme nga 24 marsi 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia dhe toskanë.

* fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të afateve dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në oren lokale, për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kufizimet. **përveç komisionit, western union përfiton para shtesë kur këmben paratë tuaja në monedhen vendase. Komisionet standarte fillojnë me 1000.01 euro të dërguara në një transaksion. Për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

WESTERN UNION | **yes!**

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodheni.

+355 42 23 49 79

transfertë parash

gettare negli appositi cestini per proteggere l'ambiente.

WESTERN UNION

© 2009 WESTERN UNION HOLDINGS, INC. All rights reserved.